



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 110 Akti

Nr. 231 Vendimi
Tiranë, më 29.01.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Pamela Qirko	Relatore
Etleda Çiftja	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Hans Kijlstra, në Tiranë, në datat 10 dhjetor 2019, ora 10:00 dhe 27 janar 2020, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Anton Martini**, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, me caktim të përkohshëm në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5, të nenit 179/b, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në pikën 5, të nenit 3, si dhe në pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Anton Martini, aktualisht me funksionin prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, me caktim të përkohshëm në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit, *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.3.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Anton Martini, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Pamela Qirko dhe Etleda Çiftja. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionere Pamela Qirko.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 26.3.2018, u caktua me mirëkuptim kryesuese komisionere Genta Tafa (Bungo), u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Anton Martini.

5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Anton Martini, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V “kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

10. Në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, Inspektoratit i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Anton Martini. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë dhe;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

11. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka dërguar raportin² e saj për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Anton Martini.

12. Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 14.11.2019, vendosi: (i) përfundimin e hetimit

¹ Shkresë nr. *** prot., datë 28.2.2018.

² Raporti nr. *** prot., datë 2.11.2017.

³ Shkresë nr. *** prot., datë 7.6.2018.

kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit, z. Anton Martini; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t`u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

15. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit në datën 15.11.2019 u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë, apo të kërkojë marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 19.11.2019 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 2.12.2019.

16. Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore⁴.

II. SEANCAT DËGJIMORE - RIÇELJA E HETIMIT ADMINISTRATIV

17. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 6.12.2019⁵.

18. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Anton Martini, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 10.12.2019, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra.

19. Subjekti i rivlerësimit, z. Anton Martini, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Anton Martini, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

20. Në datën 11.12.2019 (1 ditë pas zhvillimit të seancës dëgjimore) në Komisionin është depozituar një denoncim i ri për subjektin e rivlerësimit, z. Anton Martini.

20.1 Me qëllim kryerjen e një hetimi sa më të plotë dhe të gjithanshëm për verifikimin e pretendimeve të parashtruara në denoncimin e depozituar rishtazi në Komision, me vendimin e ndërmjetëm nr. 4, datë 11.12.2019, trupi gjykues vendosi riçeljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit z. Anton Martini i cili u njoftua për këtë vendim.

20.2 Në datën 15.1.2020, subjekti i rivlerësimit u njoftua me rezultatin shtesë të hetimit, pas shqyrtimit të denoncimit të datës 11.12.2019, mbi bazën e të cilit u vendos riçelja e hetimit administrativ. Subjekti ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 21.1.2020.

21. Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave shtesë të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Hans Kijlstra, vendosi të

⁴ Vendimi i ndërmjetëm nr. 3, datë 6.12.2019.

⁵ Subjekti në datë 6.12.2019 dhe datë 9.12.2019 paraqiti disa dokumente/prova shtesë në mbështetje të prapësimve të dërguara në datë 2.12.2019.

ftojë subjektin e rivlerësimit në seancën e dytë dëgjimore, e cila u zhvillua në datën 27.1.2020, ora 12:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0.

21.1 Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve që lidheshin vetëm me denoncimin i cili ishte bërë shkak për riçeljen e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, z. Anton Martini, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

22. Z. Anton Martini ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

22.1 Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

23. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e drejtësisë.

23.1 Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

23.2 Sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

23.3 Sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

23.4 Ndërsa, sipas kreut VI, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

23.5 Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, nr. 2/2017⁶ dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces

⁶ “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me

të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

24. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklaratën e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga Prokuroria e Përgjithshme; (ë) denoncimet e publikut; dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit, apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

25. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si edhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

25.1 Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar, “Vetting”, të paraqitur më parë në ILDKPKI duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Anton Martini.

25.2 Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

26. Apartament me sipërfaqe banimi 97.16 m², sipërfaqe të përbashkët 10.74 m², sipërfaqe tarrace 25.95 m², si edhe një post garazhi, të ndodhur në Rr. “***”, Tiranë.

Vlera e deklaruar: 90,000 euro – **pagesat janë kryer:** vlera prej 50,000 euro *cash* në datën 14.4.2015, me nënshkrimin e kontratës; dhe vlera prej 35,000 euro në datën 13.01.2017, derdhur në llogarinë e shoqërisë ndërtuese në “Tirana Bank”; detyrimi i mbetur në shumën prej 5,000 euro.

Pjesa takuese: 50 %, në bashkëpronësi me bashkëshorten.

dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtar”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

Statusi i pronës: i paregjistruar në ZVRPP.

Burimi i krijimit: kredia në vlerën prej 5,000,000 lekësh e marrë në “Raiffeisen Bank”, në vitin 2007; kredia në vlerën prej 5,200,000 lekësh e marrë në “Raiffeisen Bank”, në vitin 2016; dhe të ardhurat, ndër vite, nga puna e subjektit dhe e bashkëshortes.

Subjekti ka deklaruar se e ka fituar këtë pasuri nëpërmjet kontratës së porosisë nr. ***, datë 14.4.2015, lidhur me shoqëritë “****” sh.p.k., dhe “****” sh.p.k.

26.1 Gjithashtu, subjekti ka deklaruar shpenzime të arredimit për apartamentin e mësipërm, në vlerën prej 2,000,000 lekësh, me të njëjtat burime si të pasurisë apartament.

26.2 Deklarimet e bëra për këtë pasuri në vite: Referuar deklaratës periodike vjetore (në vijim DPV) të vitit 2015 subjekti ka deklaruar se ka porositur apartament banimi në datën 14.4.2015, me adresë: Rr. “****”, nr. ***, sipas kontratës noteriale me nr. ***, të redaktuar nga notere G.B.

Vlera e paguar: 50,000 euro; detyrimi i mbetur: 40,000 euro.

Burimi i krijimit: mbyllja e fondit të investimit në “Raiffeisen Bank”, shuma prej 37,400 euro dhe pakësimi i gjendjes *cash* nga kursimet deri në vitin 2015, shuma prej 12,600 euro.

Pjesa takuese: 50 % me bashkëshorten.

Hetimi i kryer nga Komisioni

27. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje rezulton se në datën 17.4.2015 subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratën e porosisë⁷ me shoqëritë “****” sh.p.k., dhe “****” sh.p.k., me objekt porositjen e një apartamenti banimi nr. ***, në katin e pestë të banimit, me sipërfaqe total 107.90 m², sipërfaqe të përbashkët 10.74 m², sipërfaqe apartamenti ndërtimi 97.16 m², sipërfaqe tarrace 25.95 m², dhe të një posti garazhi, në Rr. “****”, Tiranë, në total për vlerën 90,000 euro.

27.1 Në nenin 4, të kësaj kontrate me titull “mënyra e pagesës” parashikohet se: (i) deri në ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate pala porositëse ka paguar për llogari të shoqërisë së ndërtimit këstin prej 50,000 euro; dhe (ii) pjesa e mbetur prej 40,000 euro do të paguhet me marrëveshje mes palëve, e ndarë në këste deri në nënshkrimin e kontratës përfundimtare të shitblerjes mes palëve.

27.2 ZVRPP-ja Tiranë⁸ konfirmon se në emrin e subjektit të rivlerësimit është e regjistruar pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit apartament, me sip. 97.16 m².

27.3 Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-ja Tiranë rezulton se në datën 17.11.2017, subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratën e shitblerjes⁹ me shoqërinë “****” sh.p.k., sipas së cilës ka blerë pasurinë e llojit apartament me sipërfaqe 97.16 m² dhe sipërfaqe verandë 24.8 m². Këtë pasuri subjekti e ka përfituar nga pala sipërmarrëse sipas kontratës së porosisë së nënshkruar në datën 17.4.2015, duke e paguar vlerën totale të shitblerjes prej 90,000 euro, sipas kushteve dhe afateve të dakordësuara mes palëve në kontratën e porosisë.

⁷ Kontrata nr. ***, datë 17.4.2015.

⁸ Shkresat nr. *** prot., datë 10.1.2018 dhe nr. 91/1 prot., datë 16.1.2019.

⁹ Kontrata nr. ***, datë 17.11.2017.

27.4 I pyetur nga Komisioni se: si janë shlyer këstet për vlerën e blerjes prej 90,000 euro; sa është detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë ndërtuese; dhe nëse i ka kaluar në pronësi garazhi i porositur, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se¹⁰ këstet për blerjen e apartamentit nga shoqëria “***” sh.p.k., janë shlyer si vijon:

i. [...] kësti i parë, në vlerë prej 50,000 euro është shlyer në datën 7.4.2015, në bazë të faturës së arkëtimit të datës 7.4.2015, të cilat i janë dhënë administratorit të shoqërisë, z. A. H., në prani të inxhinieres së shoqërisë. Kjo shumë parash është siguruar nga tërheqja e parave në datën 30.3.2015, nga ‘Raiffeisen Bank’ në shumën prej 37,400 euro + 12,600 euro nga gjendja cash që kishte në banesë [...]¹¹;

ii. [...] kësti i dytë, prej 35,000 euro është derdhur në llogarinë e shoqërisë “***” sh.p.k., në ‘Tirana Bank’ në datën 13.1.2017. Kjo sasi parash është siguruar nga kredia e marrë nga ‘Raiffeisen Bank’ në vitin 2016 dhe paratë cash në banesë [...]¹²;

iii. [...] kësti i tretë prej 5,000 euro, nuk i ka kaluar akoma shoqërisë “***”, pasi sipas kontratës së porosisë, datë 17.4.2015, ishte porositur edhe post garazhi brenda vlerës prej 90,000 euro, por se akoma nuk i ka kaluar në pronësi, dhe për rrjedhojë nuk i ka kaluar këstin e fundit[...].

27.5 Noteri publik, znj. G.B¹³, ka dërguar kopje të kontratës së porosisë¹⁴ dhe të kontratës së shitblerjes¹⁵ të nënshkruar mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë ndërtuese për porositjen e apartamentit dhe garazhit, si dhe blerjen përfundimtare të apartamentit. Nga verifikimi i kontratës së porosisë rezulton se është e njëjtë në formë dhe në përmbajtje me kontratën e dorëzuar nga subjekti. Ndërsa kontrata e shitblerjes e depozituar nga noterja G.B., në Komision, ashtu sikurse kontrata e depozituar nga subjekti, ka datë dhe numër pasurie të ndryshme nga kontrata e depozituar në ZVRPP – për regjistrimin e kësaj pasurie.

27.6 Subjektit iu kërkuan shpjegime lidhur me mospërputhjen e konstatuar nga Komisioni për datën e deklaruar të lidhjes së kontratës së porosisë, çmimit total të paguar në momentin e lidhjes së kontratës së shitblerjes, si dhe për ndryshimin e konstatuar në disa elementë të kontratës së shitjes së depozituar në ZVRPP-në Tiranë, mbi bazën e së cilës është regjistruar kjo pasuri.

27.7 Në prapësimet e tij¹⁶ subjekti, ndër të tjera shpjegoi se në deklaratimet e tij ka bërë gabim material kur i është referuar datës 14.4.2015, si datë të lidhjes së kontratës së porosisë, duke evidentuar faktin se gjithsesi ka referuar të dhëna të sakta për numrin e repertorit dhe numrin e koleksionit të kësaj kontrate noteriale. Subjekti deklaroi se ekziston vetëm një kontratë porosie, kontrata e datës 17.4.2015, e cila është depozituar me dorëzimin e deklaratës “Vetting”.

27.8 Komisioni vëren se subjekti ka deklaruar si datë të lidhjes së kontratës datën 14.4.2015, por në vazhdimësi ka referuar numrin e repertorit dhe numri e koleksionit që i përkasin

¹⁰ Përgjigjet e pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni në datën 5.2.2019.

¹¹ Bashkëlidhur ka dërguar mandatdorëzimin e vlerave monetare të shoqërisë “***” sh.p.k. (mandatpagesë datë 7.4.2015).

¹² Për të konfirmuar këtë pagesë, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI: mandatdepozite në “Tirana Bank” që mban datën 13.1.2017, në vlerë 35,000 euro, me përfitues shoqërinë “***” sh.p.k., me përshkrim “depoziton A. Martini, blerje apartamenti sipas kontratës nr. ***”; dhe mandatërheqje cash nga llogaria në “Raiffeisen Bank” në datën 7.10.2016, shumën prej 5,000,000 lekësh, nga bashkëshortja e subjektit H.M.

¹³ Shkresa e protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 3.1.2019.

¹⁴ Kontrata nr. *** kol., datë 17.4.2015

¹⁵ Kontrata nr. ***, datë 17.7.2015.

¹⁶ Prapësimet e dërguara nga subjekti në datën 2.12.2019 nëpërmjet postës elektronike (e-mail-it), si dhe të depozituara në Komision, protokolluar me nr. *** prot., datë 2.12.2019.

kontratës noteriale të porosisë të datës 17.4.2015, e cila është depozituar nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI dhe në Komision, si dhe është konfirmuar edhe nga noteri publik, znj. G.B.

27.9 Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se ekziston vetëm një kontratë për shitblerjen e kësaj pasurie me nr. ***, datë 17.7.2017, nënshkruar përpara noterit publik, znj. G.B., dhe se kjo kontratë ka pasur gabime materiale të bëra nga noteri, që lidhen me numrin e pasurisë dhe deklarinimin e pagesës së plotë të shumës prej 90,000 euro.

27.10 Komisioni vëren se është pikërisht kjo kontratë e cila është depozituar nga subjekti i rivlerësimit në Komision, si dhe është konfirmuar edhe nga noterja G.B. Gjithashtu, referuar të dhënave të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë¹⁷ nga verifikimi i regjistrimit noterial konfirmohet se subjekti i rivlerësimit, z. Anton Martini, identifikohet si palë blerëse në nënshkrimin e kontratës së shitjes/dhurimit/kalim pasuri të paluajtshme të datës 17.7.2017, përpara noterit publik, znj. G.B.

27.11 Subjekti ka shpjeguar se në kontratën e shitblerjes noterja ka shënuar gabim numrin e pasurisë në referencë të gabuar të certifikatës së pronësisë me nr. ***, të nxjerrë në favor të shitësit, shoqërisë “****” sh.p.k., datë 5.7.2017, për pasurinë objekt transaksioni.

27.12 Nga verifikimi i kontratës noteriale të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit dhe të konfirmuar nga notere G.B., (kontrata e pa korrigjuar), vërehet se në nenin 1 të saj me titull “*pasuritë objekt kontrate*” përcaktohet se *në pronësi të shitësit¹⁸ është regjistruar pasuria e llojit apartament me sipërfaqe 97.16 m² dhe sipërfaqe verande 24.8 m², z. k. ***, vol. ***, f. ***, nr. pasurie ***, sipas certifikatës së pronësisë me nr. ***, datë 5.7.2017.*

27.13 Ndërkohë, nga verifikimi i certifikatës së pronësisë me nr. ***, datë 5.7.2017, e cila është pjesë e dosjes së kësaj pasurie të dërguar nga ZVRPP-ja Tiranë¹⁹, e cila është depozituar si provë nga subjekti i rivlerësimit konfirmohet se referon pasurinë me nr. ***, e cila aktualisht është regjistruar në emër të z. Anton Martini dhe të bashkëshortes.

27.14 Në këto kushte rezulton se noteri ka bërë korrigjimin e këtij gabimi material, duke korrigjuar edhe datën që mban kjo kontratë. Pjesa tjetër e kësaj kontrate është e njëjtë në formë dhe në përmbajtje. Komisioni vëren se korrigjimi i datës dhe i numrit të pasurisë është shoqëruar me vulën e noterit, veprim i lejuar sipas nenit 56, të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë” (ligji në fuqi për kohën kur është bërë korrigjimi i këtij akti).

27.15 Gjithashtu, në dosjen e kësaj pasurie konstatohet autorizimi lëshuar nga noterja G. B., për asistenten e saj, I.R., për aplikimin në ZVRPP-në Tiranë të kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 17.11.2017.

27.16 Për sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime aktive për regjistrimin e kësaj pasurie dhe me regjistrimin e saj është marrë zyra e noterit publik, G.B. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se duken bindëse dhe të bazuara në dokumentacion provues shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, pasi nuk evidentohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm dijenia e subjektit për ndryshimet e bëra në kontratën noteriale të shitblerjes së kësaj pasurie.

¹⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 8.5.2018.

¹⁸ Shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k.

¹⁹ Shkresat nr. *** prot., datë 10.5.2018; nr. *** prot., datë 16.1.2019.

27.17 Në referim të paragrafit të fundit të nenit 23, të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994, “Për noterinë”, i ndryshuar (ligji në fuqi për kohën kur është bërë regjistrimi i kësaj kontrate në ZVRPP Tiranë), përcaktohet se: *“Noteri ka për detyrë [...] të paraqesë për regjistrim, me pëlqimin e palëve, aktin noterial për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme pranë zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme që administrojnë regjistrin elektronik ku ndodhet pasuria e paluajtshme, brenda afatit të përcaktuar me ligj [...]”*.

27.18 Duket se znj. G.B., ka marrë pëlqimin e palëve për regjistrimin e kësaj pasurie, por në kushtet kur në këtë kontratë ishte bërë një gabim material prej saj (i paevidentuar më herët nga palët), që lidhet me numrin e pasurisë, ka marrë përsipër korrigjimin e gabimit të saj në përputhje me certifikatën e pasurisë objekt shitjeje, me qëllim përmbushjen e plotë të vullnetit të palëve.

27.19 Në kushtet kur ndryshimi i numrit të pasurisë është bërë në përputhje me të dhënat e reflektuara në certifikatën e pasurisë për apartamentin objekt transaksioni, ndryshimi i datës së kësaj kontrate nuk përbën element relevant, mbi bazën e të cilit Komisioni mund të krijojë dyshime të arsyeshme për mënyrën e fitimit të kësaj pasurie. Gjatë hetimit administrativ u provua se këto ndryshime janë kryer nga noterja, në kushtet e korrigjimit të gabimit të kryer prej saj, dhe se me regjistrimin e kësaj pasurie është marrë zyra noteriale. Për më tepër, në periudhën 17.7.2017 – 17.11.2017, nga subjekti nuk janë kryer pagesa për këtë pasuri, mbi bazën e të cilave Komisioni mund të ngrinte dyshime të arsyeshme se ky ndryshim është bërë me qëllim justifikimin e burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për pagesat e kryera për blerjen e kësaj pasurie.

27.20 Lidhur me pagesën e kryer nga subjekti i rivlerësimit deri në datën e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së pasurisë së llojit apartament, datë 17.7.2017, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit në deklaratimet e tij ka shpjeguar se deri në këtë moment ka kryer pagesën në vlerën prej 85,000 euro për shoqërinë ndërtuese. Por, konstatohet se kontrata e shitblerjes së kësaj pasurie referon pagesën prej 90,000 euro.

27.21 Nga verifikimi i kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie, rezulton se në nenin 2 të saj, me titull “çmimi i shitjes”, përcaktohet shprehimisht se: *“Çmimi i shitjes së pasurive të paluajtshme të pasurisë së sipërcituar është 90,000 euro të paguara sipas kushteve dhe afateve të dakordësuara mes palëve në kontratën e porosisë me nr. ***, datë 17.4.2015”*. Ndërsa në nenin 5 të saj, me titull “mënyrat dhe afatet e pagesës së çmimit” përcaktohet se: *“Mënyra e pagesës së çmimit të shitjes të pronës së përshkruar sa më sipër në këtë kontratë, do të jetë ajo e respektimit të kushteve dhe afateve sipas kushteve dhe afateve të dakordësuara mes palëve në kontratën e porosisë me nr. ***, datë 17.4.2015”*.

27.22 Në prapësimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se është gabim material i noteres deklarimi i pagesës së shumës prej 90,000 euro në kontratën e shitblerjes të datës 17.7.2017. Subjekti ka argumentuar se në asnjë deklaram nuk është shprehur për pagesën e vlerës prej 90,000 euro për shoqërinë ndërtuese, kjo për shkak se ende nuk ka zgjidhur problemin e garazhit të prenotuar nga subjekti në të njëjtën kontratë porosie së bashku me pasurinë e llojit apartament. Për të provuar deklaratimet e tij subjekti ka depozituar dy deklarata noteriale²⁰ të datës 19.11.2019, të nënshkruara para noteres G.B., ku në cilësinë e deklaruesve janë subjekti i rivlerësimit, z. Anton Martini dhe si përfaqësues ligjor i shoqërisë “****” sh.p.k., z. A. H.

²⁰ Deklaratat noteriale nr. ***, datë 19.11.2019; nr. ***, datë 19.11.2019.

Referuar këtyre deklaratave noteriale, përfaqësuesi ligjor i shoqërisë “***” sh.p.k., konfirmon problematikën lidhur me kalimin e pronësisë të pasurisë së llojit garazh në favor të subjektit të rivlerësimit, si dhe faktin që ka mbetur pa u paguar shuma prej 5,000 euro, shumë e cila do të paguhej si këst i fundit në momentin e kalimit të pronësisë.

27.23 Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, evidentohen dy pagesa të kryera nga subjekti për shoqërinë ndërtuese: (i) pagesa prej 50,000 euro e kryer në datën 7.4.2015;²¹ si dhe (ii) pagesa prej 35,000 euro, datë 13.1.2017, derdhur në llogarinë e shoqërisë “***” sh.p.k., në “Tirana Bank”.

27.24 Kontrata e porosisë së datës 17.4.2015 ka për objekt porositjen nga porositësi të pasurisë së llojit apartament banimi dhe të një posti garazhi. Në nenin 3 të saj, përcaktohet se *çmimi i pasurisë së porositur nga porositësi dhe i pranuar nga sipërmarrësi është në vlerën 90,000 euro*. Ndërsa në nenin 4 të saj me titull “mënyra e pagesës” përcaktohet se: *“Porositësi është i detyruar që të derdhë në llogarinë e shoqërisë vlerën prej 100 % të pasurive të prenotuara nga ana e tij, vlerë e cila do të likuidohet totalisht jashtë zyrës së noterisë sipas kësteve: (1) deri ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate pala porositëse ka paguar për llogari të shoqërisë së ndërtimit këstin prej 50,000 euro; dhe (2) pjesa e mbetur 40,000 euro do të paguhet me marrëveshje mes palëve, e ndarë në këste deri në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitblerjes”*.

27.25 Pra, referuar kontratës së sipërmarrjes rezulton se: (i) subjekti i rivlerësimit ka porositur dy pasuri nga shoqëria ndërtuese; dhe (ii) pagesa e këstit të dytë në shumën prej 40,000 euro do të paguhet me marrëveshje mes palëve, e ndarë në këste deri në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitblerjes.

27.26 Siç u evidentua edhe më sipër, kontrata e shitblerjes, datë 17.7.2017, ka për objekt vetëm shitjen e pasurisë së llojit apartament dhe nuk referon të dhëna për pasurinë e llojit garazh. Për më tepër, megjithëse kontrata referon pagesën në shumën prej 90,000 euro, lidhur me mënyrën dhe afatit të pagesës parashikon se: *“[...] do të jetë ajo e respektimit të kushteve dhe afateve sipas kushteve dhe afateve të dakordësuara mes palëve në kontratën e porosisë me nr. ***, datë 17.4.2015 [...]*.

27.27 Nga analizimi në harmoni i dy kontratave të nënshkruara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe në kushtet kur: (i) nuk evidentohet pagesë tjetër e kryer nga subjekti; (ii) nuk i ka kaluar në pronësi pasuria e llojit garazh;²² si dhe (iii) palët me vullnetin e tyre të plotë²³ kanë deklaruar se shuma prej 5,000 euro nuk është paguar ende – Komisioni çmon se shpjegimet e subjektit duken bindëse dhe të provuara për pagesën e kryer deri në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së pasurisë së llojit apartament banimi dhe vlerën e detyrimit të mbetur ndaj shoqërisë.

27.28 Për më tepër, Komisioni vëren se në datën 26.1.2017 (rreth 13 ditë pas kryerjes së pagesës së këstit të dytë) me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar, “Vetting” (shtojca 2) në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se disponon vlerën prej 800,000 lekësh si

²¹ Konfirmuar si pagesë e kryer edhe në kontratën e porosisë me nr. ***, datë 17.4.2015.

²² Moment në të cilin do të nënshkruhej kontrata përfundimtare ose e fundit për shitjen e këtyre pasurive – përcaktuar si kusht për kryerjen e pagesës së plotë në favor të shoqërisë ndërtuese.

²³ Në këndvështrim të faktit se në kontratën e porosisë parashikohej se pagesa e shumës prej 40,000 euro do të kryhej me këste me marrëveshje mes palëve dhe se palët me vullnetin e tyre të lirë nëpërmjet deklaratës noteriale ka deklaruar mospagimin e shumës prej 5,000 euro.

gjendje *cash*, për të cilën u provua se ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e kësaj shume²⁴. Në këtë këndvështrim, nisur dhe nga fakti se rezultoi e provuar se noterja në përpilimin e kontratës së shitblerjes ka bërë edhe gabime të tjera materiale, Komisioni krijoi bindjen se subjekti ka deklaruar marrëdhënien faktike lidhur me shumën e paguar për shoqërinë ndërtuese.

27.29 Komisioni vëren se subjekti nuk ka treguar kujdesin e duhur në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie, por vlerëson se kjo mund të ketë ardhur si rezultat i faktit se kjo kontratë është përpiluar nga e njëjta notere, e cila ka përpiluar kontratën e porosisë, sipas të cilës parashikohej kalimi në pronësi të subjektit i dy pasurive (apartamentit dhe garazhit), kundrejt pagesës prej 90,000 euro.

Analiza ligjore/financiare për burimin e krijimit të pasurisë së llojit apartament dhe shuma e shpenzuar për mobilimin e tij

28. Referuar deklaratës së rivlerësimit kalimtar, “Vetting” (shtojca 2), subjekti ka deklaruar si burim të krijimit të pasurisë apartament + garazh (vlera e paguar 85,000 euro), si dhe për kryerjen e shpenzimeve për mobilim (vlera e deklaruar 2,000,000 lekë), si më poshtë:

28.1 Kredi në vlerën prej 5,000,000 lekësh, në “Raiffeisen Bank”, në vitin 2007. Rezulton se në datën 15.2.2007, nëpërmjet kontratës së kredisë bankare të lidhur me “Raiffeisen Bank”, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë përfituar shumën prej 5,000,000 lekësh.

28.2 Kredi në vlerën prej 5,200,000 lekësh, në “Raiffeisen Bank”, në vitin 2016. Rezulton se në datën 29.9.2016, nëpërmjet kontratës së kredisë bankare të lidhur me “Raiffeisen Bank”, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë përfituar shumën prej 5,200,000 lekësh.

28.3 Të ardhura të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes nga puna ndër vite.

Analiza e kryer nga Komisioni, në lidhje me deklarimin, pagesën dhe burimin e deklaruar të të ardhurave që kanë shërbyer për shlyerjen e këstit të parë, për blerjen e kësaj pasurie

29. Në deklarimin periodik të vitit 2015, subjekti ka deklaruar se shuma e paguar në vitin 2015 në vlerën 50,000 euro ka si burim mbylljen e fondit të investimeve në “Raiffeisen Invest” në vlerën 37,400 euro, si dhe pakësimin e gjendjeve *cash* nga kursimet deri në vitin 2014, në vlerën 12,600 euro.

29.1 Ndërsa, në deklaratën e rivlerësimit kalimtar, “Vetting” (shtojca 2), subjekti ka deklaruar se në datën 14.4.2015 ka kryer pagesën prej 50,000 euro si kësti i parë për prenotimin e kësaj pasurie. Ndërkohë, vërehet se kontrata e porosisë, datë 17.4.2015, parashikon se deri në ditën e nënshkrimit të saj pala porositëse ka paguar për llogari të shoqërisë së ndërtimit këstin prej 50,000 euro.

29.2 Në përgjigje të pyetësorit të datës 9.2.2019, subjekti ka deklaruar se kësti i parë në vlerën prej 50,000 euro është shlyer në datën 7.4.2015. Bashkëlidhur ka depozituar mandatarkëtimin nr. ***, datë 7.4.2015, të shoqërisë “***” sh.p.k., ku pasqyrohet se shuma e arkëtuar nga subjekti për shoqërinë ndërtuese është 50,000 euro, me përshkrimin “*për blerje ap. *** (107.9 m²), këst i parë pallati leje ndërtimi nr. *** (protokoll)*”.

²⁴ Analizë e kryer në verifikimin dhe hetimin e kësaj pasurie (gjendjes *cash*), në vijim të këtij vendimi.

29.3 Nga verifikimi i DPV-ve vjetore të dorëzuara në ILDKPKI, vetëdeklarimeve të subjektit të bëra në ILDKPKI dhe në përgjigje të pyetësorëve të Komisionit konstatohet se shuma prej 37,400 euro e investuar nga bashkëshortja e subjektit në “Raiffeisen Invest” rrjedh nga kredia e marrë në “Raiffeisen Bank” në vitin 2007.

29.4 Në deklaratën “Vetting”, në rubrikën “detyrime financiare ndaj personave fizikë dhe juridikë”, subjekti ka deklaruar kredinë në vlerën 5,000,000 lekë, të marrë në vitin 2007, vlerën 2,797,847 lekë, të shlyer deri në momentin e deklarimit, si dhe detyrimin e mbetur në vlerën 3,463,560 lekë.

29.5 Ndërsa, në rubrikën “deklarimi i pasurisë” subjekti ka deklaruar kredinë për strehim të marrë në janar të vitit 2007, për të cilën sqaron se për shkak të mospërdorimit është depozituar në Bankën e Shqipërisë në titullin Bono Thesari (shuma e përfituar në total 156,000 lekë). Gjithashtu, subjekti shpjegon se gjysma e kredisë në vlerën 2,500,000 lekë, është depozituar në Bono Thesari në nëntor të vitit 2007 me afat 6 mujor, shuma e përfituar në total 72,000 lekë.

29.6 Në vijim në deklaratën “Vetting”, subjekti ka shpjeguar se: (i) në vitin 2011 shuma prej 5,000,000 lekësh e marrë në formë kredie në janar të vitit 2007 është konvertuar në 33,000 euro dhe është depozituar në bankë; (ii) në datën 7.2.2013 është tërhequr shuma e depozituar në bankë; (iii) në datën 8.2.2013 kjo shumë ka kaluar në “Raiffeisen Invest”; (iv) në datën 30.7.2014, krahas saj janë blerë kuota në shumën 5,000 euro (e cila ka ardhur nga pakësimi i gjendjes *cash* ndër vite); dhe (v) në vitin 2015 është tërhequr shuma prej 37,400 euro nga “Raiffeisen Invest” dhe duke i shtuar edhe gjendjen *cash* në banesë në vlerën 12,600 euro, është porositur apartamenti në Rr. “****”, Tiranë.

29.7 Referuar të dhënave nga “Raiffeisen Bank”²⁵ rezulton se kredia në vlerën prej 5,000,000 lekësh është *disbursuar* në datën 9.3.2007, në llogarinë nr. ***, të subjektit.

29.8 Lidhur me shumën e përfituar nga kjo kredi, rezultoi se janë kryer veprimet bankare, si vijon: (i) në datën 11.4.2007, shuma prej 5,000,000 lekësh është transferuar në llogarinë bankare në lekë të bashkëshortes së subjektit, znj. H.M.; (ii) në datën 13.4.2007, shuma prej 5,003,500 lekësh është investuar për Bono Thesari në Bankën e Shqipërisë; (iii) në datën 19.7.2007, shuma prej 498.792 lekësh është transferuar në llogarinë e bashkëshortes së subjektit me përshkrim “transferim fonde me kërkesë të klientit nga Bono Thesarit”; (iv) në datën 25.10.2007 bashkëshortja e subjektit ka tërhequr shumën prej 2,000,000 lekësh nga llogaria e Bonove të Thesarit; (v) në datën 26.10.2007, shuma prej 500,000 lekësh është tërhequr *cash* nga bashkëshortja subjektit; (vi) në datë 16.10.2008, është kthyer nga investimi për Bono Thesari shuma prej 2,489,304 lekësh; dhe (vii) në datën 5.12.2008, bashkëshortja e subjektit tërheq *cash* shumën prej 2,495,000 lekësh nga llogaria në “Raiffeisen Bank”.

29.9 Në vijim, nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosje konstatohet se bashkëshortja e subjektit: (i) në datën 16.4.2010 derdh shumën prej 5,000 euro në “Raiffeisen Bank”; (ii) në datën 28.7.2011, depoziton në “Raiffeisen Bank”, shumën prej 28,000 euro me përshkrim “derdh nga kredia”; (iii) po në datën 28.7.2011 shumën prej 33,000 euro e kalon në depozitë me afat deri në datën 7.2.2013; dhe (iv) në datën 8.2.2013 e kalon këtë shumë në fondin “Raiffeisen Invest”.

²⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 23.04.2018.

29.10 Deklarimi i kredisë në vite: Referuar deklaratës periodike të vitit 2007 konstatohet se në rubrikën “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” subjekti ka deklaruar kredinë në shumën prej 5,000,000 lekësh të marrë në “Raiffeisen Bank”. Gjithashtu, konstatohet se në DPV-në e vitit 2007 në rubrikën “të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kredia e marrë për strehim në vitit 2007, për shkak të prishjes së kontratës së porosisë/sipërmarrjes dhe mospërdorimit të menjëhershëm, është depozituar nga bashkëshortja e subjektit në Bankën e Shqipërisë, nën titullin Bono Thesari, me afat 6 muaj. Në vijim deklarohet se gjysma e kredisë, në vlerën 2,500,000 lekë është depozituar sërish nga bashkëshortja në nëntor të vitit 2007, nën titullin Bono Thesari me afat 6 muaj. Subjekti ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga interesat e depozitave në Bono Thesari në Bankën e Shqipërisë.

29.11 Në DPV-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar faktin se kredia e marrë për strehim në vitin 2007, për shkak të mospërdorimit të menjëhershëm është depozituar nga bashkëshortja e subjektit në Bankën e Shqipërisë, nën titullin Bono Thesari, me afat 6 muaj, duke deklaruar edhe të ardhurat e përfituara nga interesat.

29.12 Gjithashtu, nga verifikimi i deklaratës periodike vjetore të vitit 2011 konstatohet se në datën 3.5.2012, subjekti ka depozituar në ILDKPKI shkresën “shtesë për deklaratën e interesave periodike/vjetore për vitin 2011”²⁶, sipas së cilës subjekti ka deklaruar se – *në deklaratën e interesave private periodike/vjetore të vitit 2011, të dorëzuar prej tij në ILDKPKI nuk ka shënuar se ka konvertuar një pjesë të kredisë së marrë në vitin 2007, në ‘Raiffeisen Bank’, për strehim, e ka konvertuar në monedhën euro, në total në vlerën prej 33,000 euro. Në vijim ka sqaruar se këtë shumë në pritje të investimit për shtëpi, në datën 28.7.2011, bashkëshortja e subjektit e ka depozituar në ‘Raiffeisen Bank’ dhe ka përfituar interes deri në datën 31.12.2011, vlerën prej 143.37 euro.*

29.13 Subjekti i rivlerësimit në DPV-të e viteve 2012, 2013 dhe 2014, ka deklaruar të ardhurat e përfituara si interesa nga llogaria bankare (fillimisht llogari depozitë dhe në vitin 2013 kaluar në Fond Investimi) e krijuar në “Raiffeisen Bank”, si dhe në vijimësi në deklaratat periodike vjetore ka deklaruar kredinë e marrë në “Raiffeisen Bank”, shumën e shlyer dhe detyrimin e mbetur sipas periudhave përkatëse.

29.14 Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime, lidhur me faktin e mosdeklarimit në DPV-të përkatëse si likuiditete *cash* të shumës prej 2,500,000 lekësh në vitin 2007 dhe shumës prej 2,495,000 lekësh në vitin 2008, tërhequr nga bashkëshortja e subjektit nga depozita Bono Thesari në Bankën e Shqipërisë, me burim kredinë e marrë në vitin 2007.

29.15 Në prapësimet e tij, ndër të tjera, subjekti ka sqaruar se: *[...] nisur nga koncepti i deklaratimit për rubrikën “ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, ndër vite ka deklaruar vetëm shtesat e pasurisë së tij të krijuara në vitin përkatës dhe jo totalitetin e parave cash në shtëpi.*

29.16 Bazuar në nenin 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe rubrikës së deklaratës së interesave pasurorë privatë/vjetorë, “Ndryshimi i

²⁶ Ky dokument, shtesë në deklaram, i është bashkëlidhur deklaratës periodike vjetore të vitit 2011.

pasurive dhe burimi i krijimit”, me sqarimet përkatëse, subjekti ka pasur detyrim të deklarojë shtesat dhe pakësimet të vitit deklarues.

29.17 Komisioni, në analizën e kryer më sipër, evidentoi në mënyrë kronologjike të gjitha veprimet e kryera nga subjekti me vlerën monetare të përfituar nga kredia e marrë në vitin 2007, deklaratat e bëra lidhur me këtë kredi në deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara në ILDKPKI, si dhe deklaratat e dhëna në Komision, në kuadër të procesit të hetimit administrativ.

29.18 Nga analizimi i të dhënave të mësipërme rezulton se subjekti ka deklaruar kredinë e marrë në “Raiffeisen Bank” në DPV-në e vitit 2007 në vlerën prej 5,000,000 lekësh. Gjithashtu, Komisioni vëren se në periudhën që këto vlera monetare janë depozituar në bankë, subjekti në respektim të detyrimit ligjor ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga interesat gjatë vitit kalendarik përkatës, të ardhura që përbëjnë në vetvete shtesa pasurie për të cilat ka pasur detyrimin për deklarim dhe për të cilat Komisioni çmon se subjekti ka kryer deklarim të saktë në deklaratat periodike vjetore.

29.19 I rëndësishëm konstatohet fakti se në asnjë nga deklaratat periodike vjetore para vitit 2015²⁷, subjekti nuk ka deklaruar pakësimin e shumës prej 5,000,000 lekësh apo vlerën e konvertuar të saj të përfituar nga kredia e marrë në “Raiffeisen Bank”.

29.20 Si përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka zbatuar detyrimin ligjor për deklarimin e shumës së përfituar nga kredia si detyrim financiar në “Raiffeisen Bank”, në rubrikën e deklarimit të detyrimeve ndaj personave fizikë e juridikë, për pasojë, kjo shumë nuk do të duhej të deklarohet dhe në rubrikën e ndryshimit të pasurive, duke qenë se subjekti e kishte deklaruar marrëdhënien ligjore me të. Për më tepër, në rubrikën e shtesave dhe ndryshimeve në formularët e deklarimeve periodike pasqyrohen pasuritë në pronësi dhe në përdorim dhe jo ato që raportohen si detyrime ndaj të tretëve.

29.21 Si rrjedhim, Komisioni bazuar mbi prova, krijoi bindjen se shuma prej 37,400 euro e përfituar nga mbyllja e fondit në “Raiffeisen Invest” në vitin 2015, të cilën subjekti e deklaroi si burim krijimi të pasurisë së tij, rrjedh nga kredia në shumën prej 5,000,000 lekësh, në vitin 2007, në “Raiffeisen Bank”.

29.22 Bazuar në informacionin e përcjellë nga “Raiffeisen Invest”²⁸ rezulton se në datën 30.3.2015, bashkëshortja subjektit ka shitur kuotat e saj të investuara në këtë fond në vlerën 37,415.78 euro, *neto*.

29.23 Ndërsa, referuar të dhënave nga “First Investment Bank”²⁹ rezulton se në llogarinë rrjedhëse në euro të bashkëshortes së subjektit në datën 1.4.2015, është transferuar shuma prej 37,415.78 euro, nga “Raiffeisen Invest” dhe më pas janë të regjistruara tërheqjet si vijon: (i) në datën 3.4.2015 është tërhequr shuma prej 20,000 euro; (ii) në datën 7.4.2015 është tërhequr shuma prej 7,000 euro; (iii) në datën 8.4.2015 është tërhequr shuma prej 7,000 euro; dhe (iv) në datën 10.4.2015 është tërhequr shuma prej 3,360 euro.

²⁷ Periudhë në të cilën ka deklaruar mbylljen e fondit të investimit në “Raiffeisen Bank” me qëllim kryerjen e pagesës së kështit të parë për prenotimin e pasurisë – e cila kishte si burim krijimi kredinë e marrë në “Raiffeisen Bank” në vitin 2007.

²⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 24.4.2018.

²⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 3.5.2018

29.24 Në vetëdeklarimin e bërë në përgjigje të pyetësorit të dërguar nga Komisioni, subjekti ka shpjeguar se pagesa prej 50,000 euro, është bërë në datën 7.4.2015 (sipas mandatpagesës) dhe si një nga burimet e kësaj pagesë ka cituar shumën prej 37,400 të përfituar nga mbyllja e fondit të investimit në “Raiffeisen Invest”.

29.25 Nga verifikimet e kryera nga Komisioni rezultoi se pasi u mbyll fondi i investimit në “Raiffeisen Invest”, shuma prej 37,400 euro është transferuar në “First Investment Bank” dhe se deri në datën 7.4.2015, nga kjo bankë ishte tërhequr shuma prej 27,000 euro.

29.26 Për sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje dhe deklarimeve të dhëna nga subjekti, rezulton se në datën 7.4.2015 (data e kryerjes së pagesës prej 50,000 euro në favor të shoqërisë ndërtuese sipas mandatit), bashkëshortja e subjektit nuk kishte tërhequr plotësisht shumën prej 37,400 euro, të deklaruar si burim për pagesën e kryerjes së kështit të parë.

29.27 Lidhur me këtë konstatim, në prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit, si dhe në shpjegimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore të datës 10.12.2019, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se në momentin kur u dakordësua në parim me shoqërinë ndërtuese për porositjen e pasurive apartament dhe garazh dhe të çmimit final të tyre, do t'i likuidonte paraprakisht shoqërisë sipërmarrëse shumën prej 60,000 euro, kjo për shkak të nevojave imediate financiare të shoqërisë dhe me qëllim përfitimin e një çmimi të mirë për blerjen e këtyre pasurive prej tij. Në vijim, subjekti ka shpjeguar se së bashku me bashkëshorten zotëronin shumën e rrjedhur nga kredia në vlerën prej 37,400 euro në bankë, si dhe vlerat monetare *cash* të krijuara nga kursimet ndër vite. Subjekti konfirmon faktin se në datën 7.4.2015 (10 ditë para lidhjes së kontratës së porosisë/sipërmarrjes) ka paguar për shoqërinë ndërtuese shumën prej 50,000 euro, me burim 27,000 euro të tërhequr nga banka deri në këtë datë dhe pjesën tjetër prej 23,000 euro e ka plotësuar nga kursimet *cash* në banesë.

29.28 Gjithashtu, subjekti deklaroi se në ditët në vijim (para lidhjes së kontratës së porosisë) u tërhoq shuma e mbetur në bankë prej 10,600 euro, me qëllim plotësimin e pagesës së vlerës prej 60,000 euro të dakordësuar paraprakisht me shoqërinë ndërtuese, por meqenëse ndërtuesi e kishte kaluar situatën imediate financiare, u pagua shuma 50,000 euro, e cila është përcaktuar edhe në kontratën e porosisë së datës 17.4.2015. Në këto kushte, shuma prej 10,600 euro e tërhequr nga banka, zëvendësoi gjendjen *cash* të përdorur për pagesën e kryer në datën 7.4.2015.

29.29 Subjekti i rivlerësimit pranon pasaktësinë në deklaram duke argumentuar se ka deklaruar një shumatore të vlerës së tërhequr në bankë në atë kohë dhe diferencës për plotësimin e vlerës prej 50,000 euro nga gjendja e kursimeve *cash*, kjo pasi shuma prej 37,400 euro është tërhequr para nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes me qëllim kryerjen e pagesës për këtë pasuri.

29.30 Komisioni, në analizë të të dhënave të mësipërme, vlerëson se shpjegimet e dhëna nga subjekti lidhur me pasaktësinë e pjesshme në deklaramin e burimit për pagesën e kështit të parë, duken bindëse, kjo në konsideratë të faktit se subjekti gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni ka dorëzuar mandatarkëtimin për pagesën e kryer në datën 7.4.2015, duke konfirmuar se kjo pagesë është kryer në këtë datë.

29.31 Duke marrë në konsideratë faktin se dokumenti mandatarkëtim nuk është dokument zyrtar i parashtypur nga shtypshkronja e letrave me vlerë dhe si i tillë nuk është dokument i

njohur nga organet tatimore apo nga institucione të tjera publike, Komisioni krijoi bindjen se subjekti ka qenë i vërtetë në deklaratimet e tij të dhëna gjatë procesit të hetimit administrativ, duke deklaruar marrëdhënien reale/faktike lidhur me pagesat e kryera për shoqërinë ndërtuese dhe burimin e kryerjes së pagesave. Në rast të kundërt, subjekti do të mjaftohej me deklarinimin se pagesa prej 50,000 euro është kryer deri në datën 17.4.2015 (sipas vetë parashikimit në kontratë), moment në të cilin subjekti dhe bashkëshortja kishin tërhequr plotësisht shumën prej 37,400 euro nga “First Investment Bank”.

29.32 Vlen të theksohet, se megjithëse në datën 7.4.2015, me kryerjen e pagesës së kështit të parë të prenotimit të pasurive apartament + garazh, subjekti i rivlerësimit ka pakësuar gjendjen *cash* të mbartur deri në fund të vitit 2014 në shumën prej 23,000 euro, Komisioni vlerëson se brenda pak ditësh kjo shumë është zëvendësuar me vlerat monetare të tërhequra nga bashkëshortja e subjektit në “First Investment Bank”. Në konsideratë të analizës së kryer më sipër, si dhe faktit se ky veprim është kryer në një kohë shumë të afërt (brenda 3 ditëve, nga 7.4.2015 – 10.4.2015), Komisioni krijoi bindjen që pasaktësia në deklarinim është pa pasoja dhe, si e tillë, nuk është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar.

29.33 Në këtë kontekst, verifikimi i këtij fakti merr kuptim dhe duhet të jetë pjesë e verifikimeve që kryhen në kuadër të procesit të rivlerësimit, në zbatim të detyrimit kushtetues që ka subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimit të pikës, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës për të provuar burimin e ligjshëm të pasurive të tij.

29.34 Për sa më sipër, me qëllim evidentimin e aftësive financiare për pagesën e kryer në datën 7.4.2015, nga subjekti i rivlerësimit të çmimit prej 50,000 euro, si kësti i parë për porositjen/blerjen e pasurive apartament + garazh, Komisioni kreu analizë ligjore/financiare, për të vlerësuar mundësinë e krijimit të vlerës, si kursime gjendje *cash* në fund të vitit 2014.

29.35 Komisioni verifikoi deklaratimet e bëra nga subjekti ndër vite, për vlerat *cash*, shuma të deklaruara në DPV-të vjetore³⁰, si dhe kursime nga të ardhurat nga pagat të cilat vlerësohen se janë shtesa të gjendjeve *cash* për çdo periudhë deklarimi, kjo nisur nga deklaratimet e dhëna nga subjekti në ILDKPKI³¹ dhe në Komision³² dhe si të tilla janë reflektuar edhe në analizën financiare të kryer nga Komisioni.

³⁰ Referuar deklaratës fillestare të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar *cash* vlerën prej 250,000 lekësh; në DPV-në e vitit 2004, ka deklaruar *cash* gjendje shumën 450,000 lekë, të krijuara në vitin 2004; në DPV-në e vitit 2005, ka deklaruar shtesë në para në gjendje *cash*, shumën 600,000 lekë; në DPV-në e vitit 2006, ka deklaruar gjendje *cash* në banesë shumën 450,000 lekë; në DPV-në e vitit 2007, ka deklaruar kursime nga pagat dhe shpërblimet, shumën 500,000 lekë; në DPV-në e vitit 2008, ka deklaruar kursime nga paga dhe shpërblimet, shumën prej 400,000 lekë; në DPV-në e vitit 2009, ka deklaruar *cash* për vitin 2009 nga paga e tij dhe e bashkëshortes, shumën 500,000 lekë; në DPV-në e vitit 2010, ka deklaruar kursime vjetore shumën 700,000 lekë, të cilat pas konvertimit në euro, vlera prej 5,000 euro është depozituar në emrin e bashkëshortes në “Raiffeisen Bank”; në DPV-në e vitit 2011, ka deklaruar kursime nga paga e tij dhe e bashkëshortes (si në llogari bankare dhe në *cash*) shumën 500,000 lekë; në DPV-në e vitit 2012, ka deklaruar kursime nga paga e tij dhe e bashkëshortes gjatë vitit 2012, shumën 410,000 lekë; në DPV-në e vitit 2013, ka deklaruar kursime nga paga e tij dhe e bashkëshortes gjatë vitit 2013, shumën 420,000 lekë; në DPV-në e vitit 2014, ka deklaruar kursime nga paga e tij dhe e bashkëshortes gjatë vitit 2014, shumën 400,000 lekë; në DPV-në e vitit 2015 ka deklaruar: (i) pakësimin e gjendjes *cash* nga kursimet e krijuara deri në vitin 2014, shumën 12,600 euro (për pagesën e kështit për prenotimin e apartamentit); (ii) shtesë në *cash* gjatë vitit 2015, shumën 400,000 lekë; dhe; në DPV-në e vitit 2016, ka deklaruar kursime nga paga e tij dhe e bashkëshortes gjatë vitit 2016, shumën 250,000 lekë.

³¹ Procesverbal mbi shpjegimet e subjektit të deklarinimit të pasurive, datë 25.3.2016.

³² Përgjigjet e pyetësorit, datë 5.2.2019.

29.36 Lidhur me mundësinë e krijimit të gjendjes *cash* deri në fund të vitit 2014 rezulton se pas verifikimit të DPV-ve vjetore të dorëzuara në ILDKPKI, duket se në fund të vitit 2014 subjekti ka gjendje *cash*, në vlerën prej 4,880,000 lekësh.

29.37 Por, nisur nga deklaratat periodike vjetore të dorëzuara në ILDKPKI, si dhe referuar deklaratimeve të dhëna nga subjekti në ILDKPKI³³ dhe në Komision³⁴ për gjendjet *cash*, ndër vite, duket se në datën 31.12.2014 gjendja e mbledhur e likuiditeteve *cash* në banesë prej tij, është në vlerën 4,661,720 lekë. Ecuria e krijimit të gjendjeve *cash* ndër vite është pasqyruar, si më poshtë:

Tabela nr. 1

Viti	Deklaruar në lekë	Deklaruar, evidentuar shtesa/pakësime	Gjendje pas ndryshimeve 31/12	Përshkrim/shpjegime të dhëna në ILDKPKI dhe Komision
2003	250,000		250,000	
2004	0	450,000	700,000	
2005	0	600,000	1,300,000	
2006	0	450,000	1,750,000	
2007	0	3,000,000	4,750,000	(500,000 lekë + 2,500,000 lekë)
2008	0	2,900,000	7,650,000	(400,000 lekë + 2,500,000 lekë)
2009	0	500,000	8,150,000	
2010	0	-277,540	7,872,460	(-2,000 euro)
2011	0	-3,390,040	4,482,420	(-28,000 euro + 500,000)
2012	0	410,000	4,892,420	
2013	0	70,000	4,962,420	(-350,000 lekë + 420,000 lekë)
2014	0	-300,700	4,661,720	(-5,000 euro + 400,000 lekë)

29.38 Për sa më sipër, nga shqyrtimi i deklaratave periodike vjetore të dorëzuara në ILDKPKI, si dhe reflektimi i të dhënave të vetëdeklaruar nga subjekti në kuadër të këtij procesi administrativ, rezulton se në fund të vitit 2014 subjekti ka pasur gjendje *cash* në vlerën 4,661,720 lekë.

Të ardhura të deklaruara si të dërguara në formë dhurate nga vëllezërit

30. Në deklaratën “Vetting”, në rubrikën “deklarimi i pasurive”, subjekti ka deklaruar të ardhura të dërguara në formë dhurate nga vëllezërit gjatë 5-vjeçarit të fundit në vlerat: (i) 2,451.97 euro dhe 794,000 lekë nga vëllai, z. D.M., dhe nga bashkëshortja të cilët jetojnë në Mbretërinë e Bashkuar; (ii) 450,000 lekë nga vëllai, z. E.M., që jeton në SHBA.

30.1 Ndërkohë, në deklaratat periodike vjetore (për vitet 2011 – 2016) të dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI rezulton se shuma totale e deklaruar si e dhuruar nga vëllai, z. D.M., është në vlerën 2,004,849 lekë (e konvertuar). Gjithashtu, rezulton se në këto deklarata periodike vjetore, subjekti nuk ka deklaruar shuma të dhuruara nga i vëllai, z. E.M., që jeton në SHBA.

³³ Proceverbale mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive, datë 25.3.2016.

³⁴ Përgjigjet e pyetësorit të datës 5.2.2019.

30.2 Referuar shkresës së institucionit financiar “AK-Invest”,³⁵ pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, rezulton se në emrin e subjektit dhe të bashkëshortes për vitet 2012 – 2016 janë transferuar në total shumat 794,000 lekë dhe 1,892 euro.

30.3 Ndërsa, referuar institucionit “Unioni financiar”³⁶ rezulton se në emrin e subjektit dhe të bashkëshortes për vitet 2012 – 2016 janë transferuar në total shumat 400 euro dhe 450 USD.

30.4 Në përgjigje të pyetësorëve të datave 8.5.2018 dhe 5.2.2019, subjekti, ndër të tjetra ka deklaruar se [...] *vëllezërit e kanë ndihmuar gjatë këtyre viteve, duke bërë dërgesa të ndryshme nëpërmjet agjencive të transfertave monetare apo cash, kur kanë ardhur për vizitë në Shqipëri dhe se nga viti 2011 e në vijim, në veçanti vëllai, z. D.M., është angazhuar për ta ndihmuar në mënyrë specifike me pagesat për shkollimin e djalit dhe se këto vlera janë deklaruar nga subjekti në deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite në ILDKPKI [...].*

30.5 Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se [...] *në deklaratën e rivlerësimit kalimtar, “Vetting” ka deklaruar shumat e transferuara nga vëllezërit nëpërmjet institucioneve financiare, pasi ka marrë dokumentacionin nga agjencitë e transfertave monetare “WesternUnion” dhe “ManyGram” ose “AK-Invest”, për 5-vjeçarin e fundit [...].*

30.6 Për sa më sipër, Komisioni evidentoi mospërputhje ndërmjet shumave të deklaruara nga subjekti në deklaratën “Vetting”, si të ardhura të dhuruara nga vëllezërit e tij nëpërmjet transfertave dhe shumave të vërtetuara nga shkresat e institucioneve financiare “AK-Invest” dhe “Unioni financiar”, të dërguara gjatë 5-vjeçarit të fundit.

30.7 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këto mospërputhje në prapësime, ka shpjeguar:

a) Së pari, shuma prej 2,451.97 euro e deklaruar si e dërguar nga vëllai i subjektit, z. D. M., ka ardhur si pasojë e mbledhjes së shumave, referuar përgjigjes me shkresën nr. *** prot., datë 24.1.2017, të institucionit financiar “AK-Invest”, të cilën e ka depozituar me dorëzimin e deklaratës “Vetting”. Nga verifikimi i përgjigjes rezulton se është shënuar dy herë (dubluar) transfertat e kryer në datën 17.3.2012, ora 8:18, në vlerën 559.52 euro, e cila ka bërë që subjekti të deklarojë gabimisht, si shumë totale në euro të transferuar nga vëllai i tij, z. D.M., vlerën 2,451.97 euro dhe jo vlerën 1,892 euro (2,451 euro - 559 euro), të konfirmuar me shkresën e “AK-Invest”, drejtuar Komisionit.

b) Së dyti, subjekti sqaron se në vitin 2016, vëllai i tij ka dërguar shumën 400 USD për bashkëshorten e subjektit, znj. H.M., e ndarë në dy data të ndryshme (në datën 12.8.2016, shumën 250 USD dhe në datën 5.9.2016, shumën 150 USD). Në vijim, ka shpjeguar se duke pasur në konsideratë kursin e këmbimit të dollarit me lekun ka përlogaritur këmbimin e sasisë 400 USD, afërsisht me 45,000 lekë dhe se në deklaratën “Vetting” ka shënuar gabimisht, shumën 450,000 lekë.

30.8 Komisioni vlerëson se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me pasaktësitë në deklarimin e të ardhurave të dërguara nga vëllezërit e tij nëpërmjet institucioneve financiare, duken bindëse dhe të bazuara në dokumentacionin provues, në konsideratë të faktit se këto të dhëna janë të vetëdeklaruara nga subjekti bazuar në informacionin e marrë nga institucionet financiare dhe është depozituar në ILDKPKI, me dorëzimin e deklaratës “Vetting”.

³⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 24.1.2017.

³⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 5.2.2019.

30.9 Komisioni, në vijim të veprimeve verifikuese hetimore, i kërkoi shpjegime subjektit lidhur me raportin mes të ardhurave të deklaruara si dhurime në deklaratat periodike vjetore dhe atyre të deklaruara, si të ardhura në formë dhurimi nëpërmjet transfertave nga institucionet financiare në deklaratën “Vetting”.

30.10 Në analizë të përgjigjeve të dërguara nëpërmjet pyetësorëve, shpjegimeve të dhëna pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe sqarimeve verbale në seancën dëgjimore publike të datës 10.12.2019, Komisioni vëren se:

a. Së pari, të ardhurat e deklaruara në formë dhurimi në deklaratën “Vetting” përfaqësojnë vetëm të ardhurat e dhuruara nga vëllezërit e subjektit, të dërguara nëpërmjet institucioneve financiare.

b. Së dyti, pjesa më e madhe e këtyre transfertave janë kryer për bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit, znj. H.M., dhe se e vetmja transfertë e kryer për subjektin në vitin 2015, në shumën prej 1,000 euro rezulton të jetë e deklaruar si dhurim në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015.

c. Së treti, megjithëse deklarata “Vetting” nuk përmban rubrikë të veçantë për dhurimet³⁷, subjekti, në funksion të transparencës që kërkonte ky proces, ka treguar kujdes të shtuar duke deklaruar këto të ardhura të dërguara nga vëllezërit nëpërmjet institucioneve financiare, pjesa më e madhe e të cilave nuk janë deklaruar më parë.

30.11 Subjekti ka shpjeguar se për arsye harrese, por në asnjë rast për qëllim shmangieje apo ndonjë qëllim tjetër, disa transfertat të kryera për bashkëshorten nuk janë paraqitur në deklaratat e plotësuara prej saj (si person i lidhur me subjektin deklarues), bashkëlidhur deklaratës së tij.

30.12 Lidhur me dhurimet e deklaruara në deklaratat periodike vjetore, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se i vëllai, z. D.M., mori përsipër shpenzimet e shkollimit të nipit (djalit të subjektit) dhe për këtë arsye, që prej vitit 2012 e në vijim ka dhuruar shumën e përafërt, që i përgjigjej detyrimit për pagesën e vitit shkollor në kolegjin “***”. Subjekti deklaroi se këto shuma kryesisht i janë dhënë *cash* nga i vëllai gjatë vizitave që ka bërë në Shqipëri, në një rast nëpërmjet shokut të tij z. A.M., dhe në një rast edhe nëpërmjet transfertës nga institucionet financiare, të deklaruara në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015.

30.13 Kolegji “***”³⁸ konfirmon se djali i subjektit të rivlerësimit D. M., ka ndjekur studimet në këtë shkollë prej vitit 2011 e në vijim. Gjithashtu, nga verifikimi i sistemit *TIMS*, konfirmohet se për vitet 2011, 2012, 2013, 2015 dhe 2016 vëllai i subjektit të rivlerësimit, z. D.M., ka qenë i pranishëm në periudha të caktuara në territorin shqiptar dhe për vitin 2014 konfirmohet se ka qenë i pranishëm në territorin shqiptar z. A.M. Subjekti i rivlerësimit, me dërgimin e përgjigjeve të pyetësorit nr. 3, ka depozituar një deklaratë (shkresë e thjeshtë), sipas së cilës shtetasi A.M., shpjegon lidhjen e ngushtë me vëllain e subjektit dhe konfirmon faktin se në vitin 2014, kur ka ardhur në Shqipëri dhe me kërkesë të z. D.M., i ka dorëzuar një sasi vlere monetare vëllait të tij, z. Anton Martini. Për më tepër, nga hetimi administrativ i kryer u konstatua se ky shtetas në vitin 2013 ka kryer një transfertë (nga shteti anglez) për bashkëshorten e subjektit në shumën 335 euro, fakt ky i përmendur edhe në deklaratën e këtij shtetasi.

³⁷ Përveç rasteve kur të ardhurat e dhuruara janë deklaruar si burim krijimi të pasurisë.

³⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 12.2.2019.

30.14 Lidhur me këto shuma të deklaruara si dhurime në deklaratat periodike vjetore të dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, Komisioni vëren se në përputhje me germën “f”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, subjekti ka përmbushur detyrimin ligjor të deklarimit, duke deklaruar për çdo rast shumën e dhuruar dhe identitetin e personit prej nga ka ardhur dhurimi. Nisur nga ky fakt, por edhe bazuar në pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni çmon se me përmbushjen e detyrimit për justifikimin e ligjshmërisë së burimit të këtyre shumave (sipas parashikimit të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016), këto të ardhura të dhuruara do të përfshihen në analizën financiare.

30.15 Vlen të evidentohet fakti se dhurimet në asnjë rast nuk kanë shërbyer si burim për krijim pasurie në emër të subjektit të rivlerësimit, por ato duket se kanë shërbyer për mbulim shpenzimesh, kryesisht për përballimin e shpenzimeve të shkollimit të djalit të subjektit.

30.16 Nisur nga sa më sipër, Komisioni vlerësoi se referuar pikës 14, të nenit 3, si dhe pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, z. D.M., dhe z. E.M., (vëllezërit e subjektit), bëjnë pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast bazuar në parimin e proporcionalitetit, të shumave të deklaruara si të dhuruara në favor të subjektit të rivlerësimit.

30.17 Lidhur me burimin financiar të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e këtyre shumave të dhuruara nga vëllai i subjektit, z. D.M., i cili jeton në Mbretërinë e Bashkuar, paraprakisht, subjekti ka depozituar në Komision: (i) dokumentacion të legalizuar (me vulë apostile), të përkthyer dhe të noterizuar për të dhënat e punësimit, pagesën e taksave dhe të tatimeve për vitet 2014 – 2016³⁹; (ii) dokumentacion i ardhur nga Oficeri i Agjencisë Kombëtare të Krimit në Britani (NCA), i atashuar në Ambasadën Britanike në Tiranë, me vulën e institucionit, i përkthyer dhe i noterizuar, i cili konfirmon pagimin e taksave për vitet 2009 – 2018, nga z. D.M., në Mbretërinë e Bashkuar⁴⁰.

30.18 Referuar dokumentacionit provues të depozituar nga subjekti, rezulton e provuar se përfitimet e përgjithshme të tatueshme nga biznesi i të vëllait në Mbretërinë e Bashkuar për periudhën deri më 5.4.2015 kanë qenë 25.000 GBP, dhe për periudhën deri më 5.4.2016 kanë qenë 25.265 GBP. Ndërsa, për periudhat e mëparshme konfirmimohet e përcjellë nga Oficeri i Agjencisë Kombëtare të Krimit në Britani (NCA), i atashuar në Ambasadën Britanike në Tiranë, se shtetasi D.M., ka qenë pagues i taksave në Mbretërinë e Bashkuar që nga viti 2009 dhe se ka paguar taksat për çdo vit. Kësaj shkrese konfirmuese subjekti i ka bashkëlidhur dokumente, për të cilat shprehet se mund të merren si konfirmim zyrtar se shtetasi D.M., me referencën unike tatimore ***, ka paguar taksat në Mbretërinë e Bashkuar.

30.19 Në vijim të komunikimit me Komisionin në datën 12.11.2019, subjekti ka depozituar⁴¹ dokumentacion të legalizuar (me vulë apostile), të përkthyer dhe të noterizuar për të dhënat e punësimit, pagesën e taksave dhe tatimeve për vitet 2011 – 2014 nga i vëllai, z. D.M., i cili jeton në Mbretërinë e Bashkuar, si dhe për të ardhurat e përfituara për periudhën 2014 – 2019 nga i vëllai, z. E.M., i cili jeton në SHBA.

³⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 17.4.2019.

⁴⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 14.5.2019.

⁴¹ Protokolluar me nr. *** prot., datë 12.11.2019, në Komision.

30.20 Referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti rezulton e provuar se i vëllai, z. D.M., për periudhën 2011 – 2014 ka përfituar të ardhura në vlerën 48.305 GBP, ndërsa vëllai, z. E. M., së bashku me bashkëshorten për periudhën 2014 – 2018 kanë përfituar të ardhura në vlerën 160.494 USD.

30.21 Në analizë të të dhënave të mësipërme konstatohet se vëllezërit e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e personave të tjerë të lidhur, kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht dhurimet e kryera për subjektin.

Analiza financiare e kryer nga Komisioni (periudha 2003 – 2014)

31. Në analizën paraprake të kryer nga Komisioni, të dërguar me rezultatet e hetimit, dukej se vitet 2004, 2009, 2010 dhe 2014 paraqiteshin me balancë negative fondesh.

31.1 Pas kalimit të barrës së provës, subjekti dërgoi prapësimet e tij të shoqëruara me shpjegimet dhe provat përkatëse. Në analizë të shpjegimeve dhe të provave të reja të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, pasi Komisioni i vlerësoi me objektivitet dhe paanësi, reflektoi ndryshimet në analizën financiare, si më poshtë vijon:

a. Për vitin 2004, referuar vërtetimit nr. *** prot., (N/Z) të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, si dhe shkresës nr. *** prot., datë 25.11.2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, u morën në konsideratë të ardhura të tjera shtesë nga pagat dhe nga shpërblimet e subjektit të rivlerësimit (të paevidentuara më parë), në shumën prej 178,345 lekësh. Me shtimin e këtyre të ardhurave në analizën financiare të vitit 2004, rezultoi se ky vit paraqitet me balancë pozitive fondesh.

b. Për vitin 2009, referuar vërtetimit nr. *** prot., datë 25.10.2019, të DRSSH-së Tiranë, u morën në konsideratë të ardhura shtesë të përfituara nga bashkëshortja e subjektit nga trajtimi me raport barrë-lindjeje (të paevidentuara më parë). Me shtimin e këtyre të ardhurave në analizën financiare të vitit 2009 rezultoi se ky vit paraqitet me balancë negative fondesh në shumën prej 72,908 lekësh.

c. Për vitin 2010 janë reduktuar shpenzimet e udhëtimit bazuar në deklaratën noteriale të datës 28.11.2019, të shtetases D.Q., rezidente në shtetin italian⁴². Me eliminimin e këtyre shpenzimeve në analizën financiare të vitit 2010, rezultoi se ky vit paraqitet me balancë negative fondesh në shumën prej 24,588 lekësh.

d. Për vitin 2014 janë reduktuar shpenzimet e udhëtimit⁴³, si dhe është shtuar si e ardhur shuma e deklaruar si dhuratë nga i vëllai, z. D.M., në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014, në konsideratë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, analizës ligjore të kryer nga Komisioni, si dhe dokumentacionit provues për ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre të ardhurave. Si rezultat, në analizën financiare përfundimtare të kryer nga Komisioni, viti 2014 paraqitet me balancë negative fondesh në shumën prej 143,633 lekësh.

31.2 Pretendimet e tjera të subjektit për analizën financiare janë të karakterit deklarativ, të pabazuara në dokumentacionin justifikues ligjor dhe, si të tilla, nuk u morën në konsideratë

⁴² Në përputhje me qëndrimin e mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit [vendimi nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019], në referencë të metodologjisë së përdorur për shpenzimet e udhëtimit.

⁴³ Në përputhje me qëndrimin e mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit [vendimi nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019], në referencë të metodologjisë së përdorur për shpenzimet e udhëtimit.

nga Komisioni. Subjekti, në përfundim të analizës financiare për vitet 2003 – 2014, rezulton të paraqitet me balancë negative fondesh, në vlerën 241,129 lekë.

31.3 Komisioni vëren se në vitet, të cilat kanë rezultuar me balancë negative fondesh, subjekti i ka deklaruar si shtesa të likuiditeteve në deklaratat periodike vjetore të dorëzuara në ILDKPKI, të cilat kanë mundësuar krijimin e gjendjes totale të likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2014. Nisur nga analiza financiare e kryer, Komisioni çmon se kjo balancë totale negative fondesh deri në fund të vitit 2014, ndikon në mundësinë e krijimit të gjendjes totale *cash* në fund të këtij viti. Nisur nga analiza e gjendjes së likuiditeteve *cash*, si dhe analizës financiare për vitet 2003 – 2014, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit në rastin më të mirë ka pasur mundësi të kursejë (të mbajtur si gjendje *cash*) deri në fund të vitit 2014, shumën prej 4,420,591 lekësh (4,661,720 lekë – 241,129 lekë).

31.4 Nga sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit, ndër vite, ka deklaruar gjendje likuiditetesh *cash* të krijuar nga të ardhurat e pagave, të cilat bazuar edhe në analizën e treguesve financiare vjetore (për vitet 2003 – 2014), mundësojnë krijimin e shumës 23,000 euro, të deklaruar prej subjektit si një nga burimet për kryerjen e pagesës së kështit të parë për prenotimin e pasurive apartament dhe garazh në datën 7.4.2015.

31.5 Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime financiare të ligjshme (të ardhurat nga kredia dhe kursimet ndër vite), të cilat mundësojnë plotësisht pagesën e kështit të parë në favor të shoqërisë ndërtuese në datën 7.4.2015, në vlerën 50,000 euro.

Analiza ligjore e kredisë në “Raiffeisen Bank” në vitin 2007

32. Nga verifikimi i dosjes së kredisë në vitin 2007, konstatohet se subjekti ka aplikuar dhe ka përfituar kredi me kushte lehtësuese në zbatim të VKM-së nr. 102, datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civil të administratës shtetërore”, i ndryshuar.

32.1 Komisioni verifikoi nëse subjekti i rivlerësimit, bazuar në legjislacionin në fuqi, plotësonte kushtet për përfitimin e kësaj kredie, si dhe analizoi të gjitha veprimet juridike të kryera nga subjekti për të përfituar këtë kredi në vijim, pas marrjes dhe disbursimit të saj.

32.2 Konstatohet se me aplikimin dhe marrjen e kësaj kredie subjekti i rivlerësimit, z. Anton Martini, është përfshirë në disa veprime juridike, duke krijuar të drejta e marrë përsipër detyrime në funksion të një qëllimi, për të cilin Komisioni vlerëson se meriton kontrollin dhe verifikimin e ligjshmërisë në kuptim të këtij procesi, i cili është financimi i blerjes së një apartamenti banimi, nëpërmjet përfitimit të një kredie lehtësuese, të subvencionuar nga organet shtetërore.

32.3 Në këtë kontekst, verifikimi i këtij fakti nëse subjekti është në përputhje me vetë qëllimin e normave ligjore që parashikojnë përfitimin e këtyre kredive në harmoni me aktivitetin juridiko-civil, në të cilin është përfshirë subjekti, merr kuptim dhe duhet të jetë pjesë e verifikimeve që kryhen në kuadër të procesit të rivlerësimit, në zbatim të detyrimit kushtetues që ka subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimit të pikës 1, nenit D, të Aneksit të Kushtetutës për të provuar burimin e ligjshëm të pasurive të tij.

32.4 Përfitimi nga kjo e drejtë, kredia lehtësuese, sipas VKM-së nr. 102, datë 5.3.1999, kushtëzohej me plotësimin e disa kushteve, në thelb të të cilave qëndron mospasja në pronësi e një banese apo nevoja për sipërfaqe shtese banimi.

32.5 Me VKM-në nr. 328, datë 13.5.2005, “Për një ndryshim në vendimin nr. 102, datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civil të administratës shtetërore”, të ndryshuar, është zgjeruar kategoria e subjekteve përfitues të kredive lehtësuese, duke u shtuar edhe personat me cilësi të veçanta, kategori në të cilën Komisioni vlerëson se përfshihet subjekti i rivlerësimit, z. Anton Martini, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, në kohën e aplikimit për kredinë lehtësuese.

32.6 Në kuptim të këtyre kushteve, në vijim të analizës së mësipërme, nga hetimi administrativ rezultoi se në momentin e aplikimit për kredi, subjekti nuk ka pasur pasuri të paluajtshme në pronësi dhe se aktualisht ka në pronësi vetëm një banesë, të ndodhur në Rr. “****”, Tiranë, e cila është e financuar edhe prej kredisë lehtësuese që ka përfitur nga “Raiffeisen Bank”, në zbatim të VKM-së nr. 102, datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civil të administratës shtetërore”, e ndryshuar.

32.7 Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes së kësaj kredie të dërguar nga “Raiffeisen Bank”, konstatohet se kontrata e kredisë bankare dhe hipotekës është lidhur në datën 15.2.2007. Pjesë e dokumentacionit të dosjes së kësaj kredie është edhe dokumenti “kontratë sipërmarrjeje”, nr. ***, datë 7.11.2006, redaktuar nga noterja M.Sh., sipas së cilës subjekti ka porositur nga shoqëria “****” sh.p.k., apartamentin ***, në shumën 55,000 euro, me sip. totale 92 m², sip. e përbashkët 10.6 m², në seksionin ***, në kuotën ***, ***, Tiranë. Në kontratë, ndër të tjera, përcaktohet se kësti i parë në vlerën 15.000 euro *cash* u paguar në datën 7.11.2006 dhe kësti i dytë në vlerën 40,000 euro do të paguhet me çeljen e kredisë.

32.8 Subjekti i rivlerësimit, me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting” (shtojca 2), ka deklaruar se në datën 7.11.2006 ka lidhur kontratë sipërmarrjeje për prentim apartamenti me kompaninë “****” sh.p.k., por duke qenë se familjes nuk iu duk banesë e përshtatshme për shkak të vendndodhjes së saj në periferi të Tiranës, kjo kontratë nuk është zbatuar, pra, nuk është ekzekutuar asnjëherë për shkaqe të mosdakordësisë me shoqërinë “****” sh.p.k., duke shpjeguar se palët janë likuiduar në mënyrë informale, duke mos pasur detyrime reciproke.

32.9 I pyetur nga Komisioni⁴⁴, në vijim të shpjegimeve të tij, subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka deklaruar se [...] në muajin nëntor të vitit 2006, pasi i ishte miratuar kredia të cilën ia dhanë për shkak të punës me kushte lehtësuese, filloi të plotësonte dokumentacionin që kërkonte “Raiffeisen Bank” para se të jepte kredinë në vlerën prej 5,000,000 (pesë milionë) lekësh. Banka kërkonte, ndër të tjera, si dokumentacion edhe një kontratë porosie për banesën për të cilën do të merrej kredia dhe në kontratën e porosisë të ishte paguar një këst. Me shtetasin A.D., i cili ishte administrator i shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., subjekti nënshkroi kontratën e sipërmarrjes, sipas së cilës porositi te kjo kompani apartamentin ***, në shumën 55,000 euro, me sip. totale 92 m², sip. e përbashkët 10.6 m², në seksionin ***, në kuotën ***, në *** Tiranë. Meqenëse subjekti kishte nevojë të siguronte banesë për vete, pra, jo thjesht për të bërë dokumentet për bankën, ra dakord, në mirëbesim me administratorin, z. A.D., (edhe

⁴⁴ Pyetësori nr. 2.

për shkak të lidhjes miqësore të përbashkët me noteren znj. M.Sh.), që sasinë prej 15,000 euro që ia dha në momentin e nënshkrimit të kontratës, të mund ta tërhiqte pa penalitete, nëse bashkëshortes së tij nuk do t'i pëlqente vendi ku ishte duke u ndërtuar pallati. Diku pas rreth dy ose tri javësh, subjekti së bashku me bashkëshorten shkuan të shihnin vendin ku gjendej pallati dhe ambientet përreth tij, e pasi nuk iu pëlqeu, vendosën të kërkonin për një vend tjetër për banesën e tyre të ardhshme. Shtetasi A.D., ia ktheu sasinë prej 15,000 euro, pasi ishin kishin rënë dakord, në mirëbesim me njëri-tjetrin [...].

32.10 Në prapësimet e dërguara në Komision, si dhe në shpjegimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore të datës 10.12.2019, subjekti i rivlerësimit, për sa ka deklaruar më sipër, ndër të tjera ka shpjeguar se që nga viti 2004 për shkak të çështjeve që ka pasur në hetim dhe të kërcënimeve për të dhe familjen, që ka marrë herë pas here, ka qenë me statusin e prokurorit nën mbrojtjen e Policisë së Shtetit⁴⁵. Objektin ku gjendej apartamenti i porositur në vitin 2006 te zona e ***, e ka parë me bashkëshorten, por edhe me ekspertët e policisë së shtetit, të cilët e kishin nën ruajtje subjektin dhe familjen e tij. Kjo zonë u konsiderua krejtësisht e papërshtatshme, me kosto të mëdha të ruajtjes, sigurisë, shoqërimit, lëvizjes dhe, si rrjedhojë, subjekti sqaroi se u detyrua të vazhdonte të jetonte në banesën që kishte me qira, e cila kishte disa elemente sigurie, me vendndodhje pranë Komisarariatit Nr. ***, Tiranë.

32.11 Ndodhur në këto kushte, si dhe përballë faktit se shuma e marrë nga kredia (vlera 5,000,000 lekë) nuk mundësonte blerjen e një banese në një zonë pranë qendrës së Tiranës, subjekti ka sqaruar se paratë e marra nga kredia i depozitoi në bankë dhe vendosi për të blerë disa bono thesari. Në vijim i ka depozituar në bankë në formë llogarie depozite apo fond investimi, me qëllim sigurimin e sado pak të të ardhurave që t'i lehtësonin pagesën e qirasë deri në momentin që do të prenotonte apartamentin që zotëron aktualisht, si dhe pagesën e këstit të kredisë.

32.12 Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar se kontrata e sipërmarrjes e datës 7.11.2006 nuk është zbatuar dhe se është kryer vetëm pagesa e këstit të parë në momentin e nënshkrimit të saj, shumë e cila i është kthyer nga ndërtuesi brenda vitit 2007, sipas dakordësimit që kishin bërë palët në mirëbesim mes tyre. Të gjitha deklaratimet e subjektit konfirmohen edhe nga përfaqësuesi i shoqërisë ndërtuese, z. A.D., nëpërmjet deklaratës noteriale⁴⁶ të datës 10.1.2019. Për më tepër, rezulton se bazuar në deklaratimet e z. A.D., në datën 26.6.2007, ky apartament i është shitur më pas shtetasit A. K.⁴⁷

32.13 Bazuar në nenin 690, të Kodit Civil, i cili parashikon se: *“Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara në ligj”*, palët me veprime konkludente kanë shprehur vullnetin për ta zgjidhur kontratën me marrëveshje mes tyre, duke i anuluar të gjitha pasojat ligjore të krijuara prej saj.

32.14 Nëpërmjet VKM-së nr. 102, datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civil të administratës shtetërore”, i ndryshuar, qëllimi i autoriteteve shtetërore ka qenë të mbështesë me strehim personat me cilësi të veçanta për të ushtruar në

⁴⁵ Ka depozituar si provë, shkresën nr. ***prot., datë 2.12.2019, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit .

⁴⁶ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 10.1.2019.

⁴⁷ Subjekti ka depozituar si provë kontratën e shitjes nr. ***, datë 26.6.2007.

mënyrë sa më efikase funksionet e tyre, duke i mbështetur, por edhe duke lehtësuar jetesën e tyre për t'u dhënë mundësinë e ushtrimit të funksionit me dinjitet.

32.15 Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni u provua se destinacioni final i kësaj kredie ka qenë strehimi dhe konkretisht është përdorur për prenotimin/blerjen e pasurisë së llojit apartament banimi, të ndodhur në Rr. “****”, Tiranë, pasuria e vetme e paluajtshme në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes. Komisioni vëren se të ardhurat në formë interesash, të përfituara nga subjekti si rezultat i kalimit të shumës së marrë nga kredia për blerje të bonove të thesarit apo depozitë bankare/fond investimi, nuk kanë përballuar as detyrimet e qirasë së paguar nga subjekti për vitet përkatëse, kur ato janë përfituar në konsideratë të faktit se pagesat e bëra për qiranë në vetvete kanë të bëjnë drejtpërdrejt me strehimin e subjektit të rivlerësimit dhe të familjes së tij.

32.16 Si përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka synuar të ndihmojë ekonominë e tij familjare për të financuar me kushte lehtësuese blerjen e banesës së tij të vetme, kjo në përputhje me vetë qëllimin e autoriteteve shtetërore për implementimin e këtij programi lehtësues. Ajo që duket se mbizotëron në këtë analizë është mungesa e qëllimit për të shtuar pasuri apo për t'i siguruar vetes dhe familjes banesa luksi, apo banesa jo të domosdoshme për strehim në kurriz të taksapaguesve shqiptarë dhe duke shfrytëzuar funksionin. Por, pavarësisht këtij vlerësimi ekonomik, mënyra e sjelljes së subjektit me një kredi të butë do të vlerësohet në përfundim, së bashku me rezultatet e tjera të hetimit.

32.17 Në kushtet kur referuar kontratës së sipërmarrjes të vitit 2006 rezulton se subjekti ka paguar në datën 17.11.2006 për shoqërinë e ndërtimit “****” sh.p.k., vlerën prej 15,000 euro, Komisioni kreu analizën e tregueseve financiarë për të evidentuar mundësinë nëse subjekti ka pasur burime financiare të ligjshme për kryerjen e kësaj pagese.

32.18 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se si burim për kryerjen e kësaj pagese kanë shërbyer të ardhurat e tij ndër vite, si dhe shuma prej 2,500 euro e marrë hua mikut të tij, z. Gj.Xh.

32.19 Në referim të pikës 14, të nenit 3, si dhe pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, si vëllezërit tuaj, ashtu edhe z. Gj.Xh., bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast, bazuar në parimin e proporcionalitetit, të shumës prej 2,500 euro të dhënë hua subjektit të rivlerësimit përpara datës 17.11.2006. Subjektit iu kërkua të provojë ligjshmërinë e të ardhurave të z. Gj.Xh., të cilat kanë shërbyer për krijimin e kësaj shume.

32.20 Në shpjegimet e dhëna në përgjigje të pyetësorëve dhe në prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacionin provues për marrëdhënien me shtetasin Gj.Xh., dhe të ardhurat e tij, si vijon: (i) deklaratë noteriale⁴⁸, datë 7.2.2019, të shtetasit Gj.Xh.; (ii) vërtetim nr. *** prot., datë 22.5.2019, i Bashkisë Tiranë, sipas të cilit subjekti “****” person fizik, regjistruar me NIPT ***, është regjistruar në DPTTV në datën 1.1.2006 dhe është regjistruar në datën 9.4.2008 dhe se për vitin 2006 ka likuiduar në total detyrimet në shumën prej 20,600 lekësh; (iii) vërtetim nga DRSSH-ja Tiranë, ku ndër të tjera, pasqyrohen të ardhurat nga paga të përfituara nga shtetasi Gj.Xh., për vitin 2006; (iv) dokumentacion për aktivitetin tregtar që ish-bashkëshortja e z. Gj.Xh., ka ushtuar prej vitit

⁴⁸ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 7.2.2019.

2005, duke qenë aksionere e shoqërisë “****” sh.p.k.; (v) të dhëna të printuara nga sistemi i doganës ***, që tregojnë importet e kryera nga shoqëria “****” sh.p.k., etj.

32.21 Në analizë të dokumentacionit të mësipërm, Komisioni, bazuar në prova, krijoi bindjen se shtetasi Gj.Xh., ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme, të cilat mundësonin dhënien e huas për subjektin e rivlerësimit, në vlerën 2,500 euro.

32.22 Gjithashtu, në prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka saktësuar se shumat 3,000 USD dhe 149,950 lekë, të kaluara në datën 29.8.2006 nga bashkëshortja në llogari të babait të saj, z. S.N.,⁴⁹ (të evidentuara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ), i janë kthyer para kryerjes së pagesës për shoqërinë ndërtuese.

32.23 Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, si dhe deklaratimet e bëra prej tij në kuadër të procesit administrativ, Komisioni kreu analizën e tregueseve financiare me qëllim vlerësimin e mundësisë financiare për kryerjen e pagesës prej 15,000 euro, në datën 17.11.2006, nga ku rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për kryerjen e kësaj pagese.

Analiza e kryer nga Komisioni lidhur me deklarin, pagesën dhe burimin e deklaruar të të ardhurave që kanë shërbyer për shlyerjen e këstit të dytë, shpenzimet për mobilimin dhe krijimin e gjendjes *cash* në shumën prej 800,000 lekësh.

33. Sikurse është evidentuar më sipër, bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe në dokumentacionin e administruar në dosje, kësti i dytë në shumën 35,000 euro është shlyer në datën 13.1.2017, duke u depozituar nga subjekti në llogarinë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k. Subjekti ka deklaruar se kjo shumë është siguruar nga kredia e marrë në “Raiffeisen Bank”, në vlerën prej 5,200,000 lekësh, *disbursuar* në llogari në datën 7.10.2016.

33.1 Nga verifikimi i dokumentacionit bankar konfirmohet se në datën 29.9.2016 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë lidhur kontratën⁵⁰ e kredisë bankare dhe hipotekën me “Raiffeisen Bank”, në bazë të së cilës subjekti dhe bashkëshortja kanë përfituar shumën prej 5,200,000 lekësh. Konstatohet se në datën 7.10.2016, shuma prej 5,200,000 lekësh është *disbursuar* në llogarinë e subjektit dhe se po në këtë datë tërhiqet *cash* nga bashkëshortja shuma prej 5,000,000 lekësh. Po ashtu, konfirmohet se në datën 13.1.2017, vlera prej 35,000 euro është derdhur në llogarinë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k., në “Tirana Bank”.

33.2 Gjithashtu, referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2016 konstatohet se subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar: (i) adresën ku është regjistruar në gjendjen civile: Rr. “****”, p. “****”, k. ***, h. ***, Njësia Administrative nr. ***, Tiranë; (ii) në rubrikën “detyrime financiare”, kredi për blerje apartamenti në shumën 5,000,000 lekë, marrë në “Raiffeisen Bank”, në shtator të vitit 2016 (shuma e likuiduar është 90,300 lekë) dhe; (iii) në rubrikën “të dhëna konfidenciale” ka deklaruar shpenzime për mobilim banese në vlerën 2,000,000 lekë, me burim kredinë dhe të ardhurat tij dhe të bashkëshortes, ndër vite.

33.3 Nga analiza financiare e kryer më sipër, si dhe vlerësimi që ka bërë Komisioni mbi ecurinë e krijimit të likuiditeteve *cash* ndër vite, duket se në rastin më të mirë, subjekti i rivlerësimit në

⁴⁹ Sipas shpjegimeve të subjektit të dhëna në pyetësorin nr. 3, z. S.N., në atë periudhë ka aplikuar për vizë në Ambasadën Italiane dhe këto shuma janë transferuar për shkak se i duheshin si depozitë, për efekt të dokumentacionit të paraqitur në ambasadë dhe nëse do i duheshin për t’i përdorur. Në përgjigjet e këtij pyetësori, subjekti ka deklaruar se këto shuma i janë kthyer brenda vitit 2006, por pa specifikuar periudhën përkatëse (ka depozituar dokumentacion provues për pajisjen me vizë në Ambasadën Italiane, të shtetasit S.N.).

⁵⁰ Kontratë nr. ***, datë 29.9.2016.

fund të vitit 2014 ka pasur mundësi të akumulojë gjendjen e likuiditeteve *cash* në shumën prej 4,420,591 lekësh.

33.4 Referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2015 konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (1) pakësim të gjendjes *cash* nga kursimet e krijuara deri në vitin 2014, shumën prej 12,600 euro (për pagesën e këstit për prenotimin e apartamentit); dhe (2) shtesë në *cash* gjatë vitit 2015, shumën prej 400,000 lekësh. Ndërsa, referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2016, ka deklaruar kursime nga paga e tij dhe e bashkëshortes gjatë vitit 2016, shumën prej 250,000 lekësh.

33.6 Trupi gjykues vlerëson se subjekti ka zbatuar detyrimin ligjor për deklarimin e shumës së përfituar nga kredia, si detyrim financiar në “Raiffeisen Bank” në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016 në rubrikën e deklarimit të detyrimeve ndaj personave fizike e juridike, për pasojë, kjo shumë nuk do të duhej të deklarohet edhe në rubrikën e ndryshimit të pasurive, duke qenë se subjekti e kishte deklaruar marrëdhënien ligjore me të. Për më tepër, në rubrikën e shtesave e ndryshimeve në formularët e deklarimeve periodike, pasqyrohen pasuritë në pronësi e përdorim dhe jo ato që raportohen si detyrime ndaj të tretëve. Gjithashtu, vërehet se kjo shumë e marrë nga kredia është deklaruar si burim për mobilimin e shtëpisë dhe për pagesën e këstit të dytë në favor të shoqërisë ndërtuese, pakësim i cili është deklaruar me dorëzimin e deklaratës “Vetting”, e cila është dorëzuar para deklaratës periodike vjetore të vitit 2016.

33.7 Lidhur me mosdeklarimin në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016, të detyrimit ndaj shoqërisë ndërtuese, Komisioni çmon se kjo pasaktësi në deklarim është pa pasoja dhe, si e tillë, nuk është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të rivlerësimit përfundimtar, kjo edhe për faktin se deklarata periodike vjetore e vitit 2016 është dorëzuar pas deklaratës së rivlerësimit kalimtar, në të cilën subjekti ka deklaruar saktësisht detyrimin e mbetur ndaj shoqërisë ndërtuese.

33.8 Në analizën financiare paraprake për vitet 2015 – 2016, të kryer nga Komisioni, të dërguar me rezultatet e hetimit, dukej se viti 2015 paraqitej me balancë negative fondesh. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti dërgoi prapësimet e tij të shoqëruara me shpjegimet dhe provat përkatëse. Në analizë të shpjegimeve dhe provave të reja të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, pasi Komisioni i vlerësoi me objektivitet dhe paanësi, reflektoi ndryshimet në analizën financiare, si më poshtë vijon: (i) shtesë në të ardhurat nga pagat e subjektit të rivlerësimit, në referim të vërtetimit me nr. *** prot., datë 25.11.2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; si dhe (ii) shtesë si të ardhura, shumën e plotë deklaruar si dhuratë nga vëllai, z. D.M., në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015, në konsideratë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, analizës ligjore të kryer nga Komisioni, si dhe dokumentacionit provues për ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre të ardhurave. Si rezultat, në analizën financiare përfundimtare të kryer nga Komisioni, viti 2015 paraqitet me balancë negative fondesh në shumën prej 15,884 lekësh.

33.9 Për sa më sipër, konstatohet se subjekti ka pasur burime financiare të ligjshme, të cilat mundësojnë shpenzimet e mobilimit të banesës në shumën 2,000,000 lekë, në vitin 2016.

33.10 Nisur nga analiza e mësipërme, duket se për vitet 2015 dhe 2016 në rastin më të mirë, subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të krijojë kursimet në gjendjen *cash* në shumën prej 634,116 lekësh (400,000 lekë⁵¹ + 250,000 lekë⁵² – 15,884 lekë⁵³).

33.11 Në vijim u përllorarit gjendja e vlerave monetare *cash* të zotëruara nga subjekti në fund të vitit 2016. Gjendjes së likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2014 (vlera prej 4,420,591 lekësh), pasi i shtojmë vlerën e evidentuar si të mundshme për t'u kursyer për vitet 2015 – 2016 (shuma prej 634,116 lekësh), dhe vlerën e tërhequr nga kredia e *disbursuar* në tetor të vitit 2016 (shuma prej 5,000,000 lekësh), rezulton vlera prej 10,054,707 lekësh. Kësaj shume, pasi i zbritet vlera e deklaruar, si pakësim të gjendjes *cash* për vitin 2015 (shuma prej 12,600 euro, konvertuar 1,769,292 lekë) dhe vlera e deklaruar për mobilimin e apartamentit (shuma prej 2,000,000 lekësh), rezulton vlera 6,285,415 lekë.

33.12 Pra, nisur nga deklaratat periodike vjetore të dorëzuara në ILDKPKI, si dhe referuar deklarimeve të dhëna nga subjekti në ILDKPKI dhe në Komision⁵⁴ për gjendjet *cash* ndër vite, duket se në datën 31.12.2016, gjendja e mbledhur *cash* në banesë është 6,285,415 lekë.

33.13 Komisioni, me qëllim evidentimin e mundësisë së kryerjes së pagesës prej 35,000 euro (kësti i dytë i apartamentit) në datën 13.1.2017, si dhe krijimin e gjendjes *cash* prej 800,000 lekësh, të deklaruar nga subjekti si gjendje në deklaratën “Vetting” në datën 26.1.2017, kreu analizën e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2017 – 26.1.2017.

33.14 Referuar analizës së treguesve financiarë, të kryer nga Komisioni, konstatohet se subjekti ka pasur burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht kryerjen e pagesës së kështit të dytë për blerjen e apartamentit, në vlerën prej 35,000 euro, si dhe krijimin e gjendjes *cash* në datën 26.1.2017, në vlerën prej 800,000 lekësh.

34. Pasuria e llojit automjet, tip “Mercedez Benz”⁵⁵, vit prodhimi 2000, me vlerë 200,000 lekë, blerë në datën 30.9.2015, me targa AA ***.

Si burim krijimi ka deklaruar të ardhurat ndër vite. Pjesa takuese 50 % në bashkëpronësi me bashkëshorten.

34.1 Nga verifikimi i deklaratës periodike vjetore të vitit 2015 rezulton se subjekti ka deklaruar këtë pasuri të shtuar, vlerën e saj dhe burimin e krijimit (të ardhurat e vitit 2015), si dhe ka referuar kontratën noteriale mbi bazën e së cilës ka fituar këtë pasuri.

Hetimi i kryer nga Komisioni

35. DPSHTRr-ja dhe DRSHTRr-ja Tiranë⁵⁶ informojnë se subjekti ka të regjistruar pasurinë automjet, tip “Mercedez Benz”, modeli C 220, vit prodhimi 2000. Nga verifikimi i dosjes së automjetit konfirmohet se në datën 30.9.2015, kjo pasuri është blerë nga shtetasja I.H., në vlerën prej 200,000 lekësh.

⁵¹ Shumë e deklaruar si gjendje *cash*, e kursyer në fund të vitit 2015.

⁵² Shumë e deklaruar si gjendje *cash*, e kursyer në fund të vitit 2016.

⁵³ Balanca negative e fondeve për vitin 2015, për të cilën Komisioni vlerëson se afekton mundësinë e krijimit të gjendjes *cash* në fund të vitit 2015.

⁵⁴ Përgjigjet e pyetësorit të datës 5.2.2019.

⁵⁵ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (Aneks ***, në dosjen e ILDKPKI-së): (1) kontratë shitblerjeje automjeti me nr. ***, datë 30.9.2015; (2) certifikatë pronësie dhe leje qarkullimi të automjetit, në emër të znj. I.H.

⁵⁶ Shkresat me nr. *** prot., datë 24.4.2018 dhe nr. *** prot., datë 10.1.2019.

35.1 Gjithashtu, rezulton se shtetasja I.H., është bërë pronare e këtij automjeti në vitin 2008, duke e përfituar nga shtetasi italian F.B. Nuk ka të dhëna për çmimin e blerjes së automjetit nga shtetasja I.H., por në dokumentacionin që gjendet në dosjen e DPSHTRr-së evidentohet vetëm fakti i kalimit të pronësisë shtetases I.H., në datën 10.10.2008, Padova, Itali. Ky fakt konfirmohet edhe nga certifikata e pronësisë së automjetit, lëshuar nga autoritetet italiane për shtetasen I.H., po në datën 10.10.2008.

35.2 Për këtë automjet në datën 26.12.2011, janë kryer procedurat e zhdoganimit në shtetin shqiptar nga shtetasja I.H. Rezulton se vlera e deklaruar e këtij automjeti është 250,000 lekë, ndërsa baza e taksueshme mbi bazën e të cilës janë paguar detyrimet doganore është 270,955 lekë, dhe shuma e detyrimit të paguar është 54,191 lekë.

35.3 Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga DPSHTRr-ja për dosjen e këtij automjeti rezultoi se, policia e sigurimit, datë 5.3.2018, e kompanisë “****” për këtë automjet, është në emër të shtetases I.H., ku shënohet si përdoruese dhe pronare e këtij automjeti. Gjithashtu, nuk rezultoi që të jetë nxjerrë nga DPSHTRr-ja certifikata e pronësisë së automjeti, në emrin e subjektit të rivlerësimit.

35.4 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni lidhur me këtë fakt, ndër të tjera, ka deklaruar se *[...]pasi ka nënshkruar kontratën e shitblerjes, për shkak të ngarkesave në punë dhe të një neglizhence nga ana tij, nuk ka nxjerrë certifikatën e pronësisë deri më datën 9.3.2018 (datë në të cilën është nxjerrë certifikata në emrin e subjektit). Është e vërtetë që te policia e sigurimit e kompanisë “****” për këtë automjet me nr. ***, datë 5.3.2018, është emri i shtetases I.H., pasi nuk kishit ndërruar pronësinë[...].* Subjekti ka depozituar si dokumentacion provues, kopjen e certifikatës së pronësisë në emrin e tij për automjetin tip “Mercedez Benz”, C220 CDI, me targa AA ***.

35.5 Për sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri. Megjithëse në momentin e deklarimit, formalisht, nuk kishte nxjerrë në DPSHTRr-në certifikatën e pronësisë së këtij automjeti, subjekti i rivlerësimit është bërë pronar i kësaj pasurie me nënshkrimin e kontratës së shitblerjes, në datën 30.9.2015.

Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

36. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht. Nga hetimi administrativ dhe shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

36.1 Subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë, pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Anton Martini, nuk vërtetohen shkaqe që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

36.2 Siç u evidentua edhe më sipër, Komisioni analizoi, vlerësoi dhe mori në konsideratë qëndrimin e subjektit në harmoni me provat e administruara në dosje, duke pranuar dhe

reflektuar të gjitha efektet e shpjegimeve bindëse dhe të bazuara në dokumentacion justifikues ligjor në rezultatet financiare të viteve përkatëse.

36.3 Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë në deklaram dhe balancat negative të fondeve në disa vite, për një total të akumuluar në shumën prej 257,000 lekësh (të evidentuar si më sipër), nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësimi sigurisht që duhet të kryhet nëpërmjet një analizë kritike, por duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

36.4 Për më tepër, Komisioni gjatë hetimit administrativ konstatoi se në asnjë rast pasaktësitë e konstatuara apo balancat negative të fondeve nuk kanë ndikuar në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe duke konsideruar faktin se mangësitë financiare janë në vlera relativisht të vogla e të shpërndara në vite, mund të gjejnë mbulim në shpjegimet e dhëna nga subjekti me prapësimet e dërguara, për të cilat Komisioni me të drejtë vlerësoi se janë të karakterit deklarativ dhe, si të tilla, nuk janë reflektuar në analizën financiare.

36.5 Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaramet e pasakta të konstatuara si më sipër nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe të mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e prokurorit dhe as besimin e publikut të drejtësia.

36.6 Gjithashtu, në lidhje me kredinë e përfituar në vitin 2007, Komisioni vlerëson se përdorimi i mjeteve monetare të përfituara me anë të kredisë, me kriteret lehtësuese nga subjekti dhe të përdorura për blerjen e bonove të thesarit, duke siguruar të ardhura për përballimin e qirasë së shtëpisë dhe të kësteve të kredisë, nuk përputhen me etikën e prokurorit dhe duket sikur e cenon atë.

36.7 Nga ana tjetër, pasi analizoi qëllimin e përdorimit të kësaj kredie, masën e të ardhurave të siguruar, mënyrën e përdorimit të tyre, Komisioni arrin në konkluzionin se kjo shkelje nuk mund të jetë shkak i mjaftueshëm për shkarkimin e subjektit. Një rast i shkëputur nuk mund të jetë cenim i etikës së prokurorit, sidomos duke vënë në balancë rezultatet profesionale të punës së tij si prokuror i Krimeve të Rënda.

36.8 Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Anton Martini, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

37. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Anton Martini, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

37.1 Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin⁵⁷ mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Anton Martini, ku ka konstatuar: (i) formulari i deklaramit është i plotë, i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

37.2 Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit.

37.3 Në vijim, Komisioni i kërkoi DSIK-së të përditësojë raportin, duke pasqyruar edhe informacionet e marra rishtazi, të cilat nuk ishin përfshirë në raportin e kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Anton Martini.

37.4 Në raportin e përditësuar⁵⁸, DSIK-ja çmon se në vlerësim të të dhënave të ardhura pas konstatimit fillestar mbi subjektin e rivlerësimit, gjykon se nuk ndodhet para asnjë rrethane apo fakti të qenësishëm që mund të vërtetojë përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në veprimtari të kundërligjshme, në papajtueshmëri me detyrën e tij funksionale. Grupi i Punës konfirmon konstatimin fillestar për përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit, z. Anton Martini.

37.5 Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit, z. Anton Martini, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara rishtazi nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

38. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Anton Martini, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

Raporti i mbajtur nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme

39. Ky raport është përgatitur nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

⁵⁷ Raporti nr. *** prot., datë 2.11.2017 (deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 17.10.2018, të KDZh-së).

⁵⁸ Raporti nr. *** prot., datë 5.7.2019 (raport i deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 5.7.2019, të KDZh-së).

39.1 Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (1) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave dhe dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (2) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (3) të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme.

39.2 Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

39.3 Referuar raportit konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka aftësi të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, arsyetimit ligjor, organizimit të punës dhe në respektimin e afateve hetimore. Subjekti i rivlerësimit është *eficient* dhe efektiv në drejtim të kohës së hetimit.

39.4 Në vlerësimin e respektimit të disiplinës në punë vërehet se subjekti i rivlerësimit ka përmbushur me besnikëri dhe disiplinë të gjitha angazhimet profesionale, personale, morale dhe etike në ushtrimin e funksioneve të tij dhe se komunikimi në cilësinë e prokurorit është korrekt dhe ligjor.

39.5 Gjithashtu, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, z. Anton Martini, ka cilësi të mira bashkëpunuese, si dhe është i gatshëm të punojë në grup dhe me agjenci të tjera ligjzbatuese. Subjekti i rivlerësimit, në vazhdimësi, ka shprehur gatishmëri për t'u rritur profesionalisht, duke kryer trajnime në Shkollën e Magjistraturës dhe një sërë trajnimesh jashtë vendit, tej programit të Shkollës së Magjistraturës.

39.6 Për periudhën e vlerësimit rezultoi se në Prokurorinë e Përgjithshme janë të arkivuara në sektorin e burimeve njerëzore vlerësimet e punës të kryera për tri vitet e periudhës së rivlerësimit nga Prokurori i Përgjithshëm, sipas të cilave prokurori Anton Martini është vlerësuar “shumë mirë”.

39.7 Gjithashtu, sipas të dhënave arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme, për subjektin e rivlerësimit ka rezultuar disa ankesa dhe dy kallëzime penale, për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Lidhur me ankesat e depozituara ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Anton Martini, Prokuroria e Përgjithshme, në shqyrtimin e tyre, nuk ka gjetur elemente apo *indicie* për nisjen e procedimit disiplinor.

Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni

40. Hetimi i Komisionit, lidhur me këtë kriter, është bazuar në verifikimin dhe analizimin e: (i) raportit për analizimin e aftësisë profesionale të kryer nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në dokumentacionin bashkëlidhur tij; (ii) vlerësimit të denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar në ankesat e subjekteve denoncuese; (iii) kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

41. Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet penale të përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme.

41.1 Pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale të kryer nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i

rivlerësimit, pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të të dhënave nga burimet arkivore mbi të cilën është hartuar ky raport, Komisioni nuk konstatoi problematika thelbësore lidhur me vlerësimin profesional.

Denoncimet e publikut të depozituara në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit

42. Denoncimi nr. *** prot., datë 26.1.2018, i shtetases Sh.I.

42.1 Denoncohet, ndër të tjerë, subjekti i rivlerësimit, z. Anton Martini, për vendim të padrejtë dhe proces jo të rregullt ligjor. Denoncuesja pretendon se djali i saj është dënuar padrejtësisht për një vepër penale që nuk e ka kryer dhe se vendimi është marrë pa u bazuar në prova konkrete. Ajo pretendon se nuk është kryer asnjë hetim nga prokurori Anton Martini, në cilësinë e prokurorit të çështjes.

42.2 Nga verifikimi i këtij denoncimi nuk rezulton të jetë dhënë ndonjë fakt apo rrethanë konkrete, nga të cilat mund të provohen pretendimet e denoncuesit për proces jo të rregullt ligjor dhe, konkretisht, për veprimet hetimore të kryera nga prokurori Anton Martini.

42.3 Denoncuesja i ka bashkëlidhur denoncimit vendimin nr. ***, datë 8.6.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ku duket se janë parashtruar të gjitha pretendimet e personit të gjykuar për procesin e zhvilluar ndaj tij.

42.4 Referuar këtij vendimi, konstatohet se:

i. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 12.3.2015, ndër të tjera, ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit B.B.I., për veprën penale “trafikim të fëmijëve”, të mbetur në tentativë, sipas nenit 128/b/1 dhe 22, të Kodit Penal dhe dënimit e tij me 7 vjet burg.

ii. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 26.5.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 12.3.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

iii. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, në datën 23.6.2015 i gjykuari B.I., ka ushtruar rekurs, i cili kërkoi prishjen e vendimeve dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

iv. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi mori në shqyrtim në dhomë këshillimi këtë çështje penale, në datën 8.6.2017 vendosi mospranimin e rekursit të ushtruar nga i gjykuari B.I., pasi rekursi i ushtruar nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432, i Kodit të Procedurës Penale.

42.5 Nisur nga ky vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, duket se nuk jemi në kushtet e parashikuara në nenin 432 Kodit të Procedurës Penale, pra, në vendimet e marra nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë ndaj të gjykuarit B.I., nuk kemi të bëjmë me: (1) mosrespektim apo zbatim të gabuar të ligjit penal; (2) shkelje që të kenë sjellë si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit të gjykatës; apo (3) shkelje të natyrës procedurale, të cilat kanë ndikuar në dhënien e vendimit.

42.6 Rezulton se të trija shkallët e gjyqësorit nuk kanë konstatuar shkelje të natyrës procedurale të pretenduara nga denoncuesi, të kryera nga prokurori Anton Martini gjatë hetimit të kryer për këtë çështje.

42.7 Bazuar në pikën 4, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësimi i aftësive profesionale të prokurorëve

çmohet pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën që vlerësohet.

42.8 Nisur nga sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se faktet dhe shkaqet për të cilat bëhet ankesa, të cilat lidhen me mënyrën e përfundimit të themelit të çështjes gjyqësore (në këtë rast të kërkesës për gjykim nga prokurori), nuk janë objekt shqyrtimi nga Komisioni, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

42.9 Si përfundim, bazuar në të dhënat dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion nga denoncuesi, duket se nuk ka *indicie* për të provuar pretendimin e tij për gjetje që do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

43. Denoncimi nr. *** prot., datë 2.2.2018 dhe denoncimi nr. *** prot., datë 28.1.2019, i shtetasve R.Xh.S., (***) dhe F.Xh.Xh.

43.1 Nëpërmjet këtyre ankesave, subjekti i rivlerësimit denoncohet për kryerjen e shkeljeve të rënda ligjore në hetimin e çështjes me të pandehur shtetasin R.S., (***). Janë dy denoncime që kanë objekt të njëjtë dhe ngrenë pretendime për shkelje të rënda të kryera nga subjekti i rivlerësimit në hetimin e çështjes penale, në ngarkim të shtetasit R.S., (***)

43.2 Pretendohet se ndaj shtetasit R.S., (***) është zhvilluar një proces i montuar politikisht dhe se subjekti i rivlerësimit ka manipuluar dëshmi, ka kryer shantazhe, presione dhe mashtrime në hetimin e kësaj çështjeje. Gjithashtu, denoncohet fakti se i pandehuri R.S., (***), në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale është pyetur pa praninë e avokatit, duke iu nënshtruar presioneve në dhënien e dëshmisë së tij. Çështja për të cilën është hetuar, gjykuar dhe dënuar shtetasi R.S., (***) ka të bëjë me ngjarjet e ndodhura në vitin 1997 në qytetin e Cërrikut. Denoncuesi F.Xh., i ka bashkëlidhur denoncimit vendimet gjyqësore të marra për çështjen objekt denoncimi.

43.3 Përshkrimi i procesit gjyqësor:

i. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, përfaqësuar nga prokurorët A.Xh., dhe Anton Martini, ndër të tjera, ka kërkuar: (1) deklarimin fajtor të shtetasit R.S., (***) për kryerjen e veprës penale “vrasje në rrethana të tjera të cilësuar”, ndaj punonjësve të policisë dhe ushtarakëve gjatë kryerjes së detyrës, kundër dy ose më shumë personave të kryer në bashkëpunim, vepra penale të parashikuara nga gerrat ‘c’ dhe “dh”, të nenit 79 dhe neni 25, i Kodit Penal; (2) deklarimin fajtor të shtetasit R.S., (***) për kryerjen e veprës penale “vrasje në rrethana të tjera të cilësuar”, të mbetur në tentativë, ndaj punonjësve të policisë dhe ushtarakëve gjatë kryerjes së detyrës, kundër dy ose më shumë personave të kryer në bashkëpunim, vepra penale të parashikuara nga gerrat ‘c’ dhe “dh”, të neni 79 dhe nenet 25 dhe 22, të Kodit Penal; (3) në zbatim të nenit 55, të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit R.S., (***) përfundimisht me burgim të përjetshëm.

ii. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 20.12.2011, ndër të tjera, ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurit R.S., (***), bazuar në akuzat e ngritura nga prokuroria dhe në zbatim të nenit 55, të Kodit Penal ka vendosur dënimin e tij me burgim të përjetshëm. Gjykata e ka deklaruar të pafajshëm të pandehurin vetëm për akuzën “vrasje në rrethana të tjera të cilësuar” ndaj punonjësit të policisë Q.M.

iii. Kundër këtij vendimi ka ushtruar të drejtën e ankimit shtetasi R.S., (***). Por, edhe Prokuroria e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, përfaqësuar nga prokurori A.L., kërkoi ndryshimin e pjesshëm të vendimit penal nr. ***, datë 20.12.2011, të Gjykatës së Shkallës së

Parë për Krime të Rënda Tiranë, ku, ndër të tjera, për shtetasin R.S., (***) ka kërkuar deklarimin fajtor edhe për akuzën e “vrasjes në rrethana të tjera të cilësuar”, ndaj punonjësit të policisë Q. M., ndërsa për pjesën tjetër të vendimit ndaj tij të lihet në fuqi dhe, në zbatim të nenit 55, të Kodit Penal, dënimin e tij me burgim të përjetshëm.

iv. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 4.6.2012, ndër të tjera, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 20.12.2011, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, për të pandehurin R.S., (***)

v. Kundër vendimit nr. ***, datë 4.6.2012, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë ka ushtruar rekurs Prokuroria e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, si dhe të pandehurit R.S., (***) dhe E.G., nëpërmjet mbrojtësve të tyre.

vi. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. ***, datë 9.12.2015, ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 4.6.2012, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë me një tjetër trup gjykues.

vii. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 31.1.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 20.12.2011, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

viii. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs i pandehuri R.S., (***), nëpërmjet avokatit mbrojtës të tij.

43.4 Duket se, megjithëse në hetimin, gjykimin dhe dënimin e shtetasit R.S., (***) kanë marrë pjesë edhe prokurorë dhe gjyqtarë të tjerë, denoncimi i tij dhe i të vëllait është bërë vetëm kundrejt prokurorit Anton Martini, me pretendimin se ka pasur presione prej tij dhe se i pandehuri është pyetur pa praninë e avokatit, në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale.

43.5 Nga verifikimi i vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë vërehet se kjo çështje është kthyer për rigjykim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, kryesisht duke pranuar shkaqet e rekursit të Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

43.6 Duke shqyrtuar shkaqet e rekursit të Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, lidhur me cilësimin e deklarimeve të marra gjatë hetimit nga organi i akuzës, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka argumentuar se gjatë hetimit të pandehurit R.S., (***) dhe shtetasi M. T., nuk janë pyetur në cilësinë e deklaruesve, por janë pyetur në cilësinë e personave nën hetim, në kuptim të nenit 34, në lidhje me nenet 296 dhe 315 të Kodit të Procedurës Penale.

43.7 Në vijim, Kolegji Penal konstaton se personave nën hetim u është bërë e ditur nga organi procedues e drejta për t’iu siguruar një mbrojtës gjatë marrjes në pyetje, si dhe e drejta e heshtjes, pra, që nuk kanë asnjë detyrim të përgjigjen, por të hetuarit nuk e kanë shfrytëzuar këtë të drejtë. Ata kanë deklaruar që shpjegimet t’i japin pa praninë e mbrojtësit.

43.8 Në lidhje me praninë ose jo të mbrojtësit gjatë marrjes në pyetje të personit nën hetim, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë⁵⁹ ka interpretuar këtë të drejtë si vijon: “*Duke analizuar dhe çmuar së bashku me nenet 49/1 dhe 296/1 të Kodit të Procedurës Penale, Gjykata Kushtetuese vlerëson se qëllimi i dispozitës është garantimi i mbrojtjes së detyrueshme nëse e kërkon personi ndaj të cilit zhvillohen hetime. Por, ky detyrim për garantimin e mbrojtjes të palës së akuzuar nuk është kategorik nëse personi ndaj të cilit zhvillohen hetime nuk e kërkon atë. Në të kundërt, nëse ai e kërkon, pala akuzuese duhet t’ia sigurojë mbrojtjen konform*

⁵⁹ Vendimi nr. ***, datë 18.12.2007.

urdhërimeve të nenit 296/1, të Kodit të Procedurës Penale. Pra, kjo e drejtë nuk barazohet me mbrojtjen e detyrueshme, pasi nga ajo mund të hiqet dorë nga personi me vullnet të lirë.”

43.9 Konstatohet se për të njëjtën çështje shtetasi R.Xh., ka bërë ankesë drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm. Kjo ankesë është trajtuar në raportin për vlerësimin e aftësisë profesionale⁶⁰, të hartuar nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme për këtë subjekt. Prokuroria e Përgjithshme, në shqyrtimin e saj, nuk ka gjetur elementë apo *indicie* për nisjen e procedimit disiplinor ndaj subjektit të rivlerësimit.

43.10 Për sa më sipër, nga shqyrtimi i këtij denoncimi duket se nuk vërehen fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin etiko-profesional për subjektin e rivlerësimit, z. Anton Martini.

44. Denoncimi nr. *** prot., datë 15.3.2018, i shtetasit V.P.

44.1 Nga përmbajtja e denoncimit vërehet se kemi të bëjme me pretendime të cilat nuk lidhen me çështje konkrete të hetuara nga prokurori Anton Martini. Denoncuesi nuk ka pasqyruar të dhëna konkrete lidhur me vendimin/vendimet e marra nga prokurori Anton Martini dhe gjithashtu nuk i ka bashkëlidhur denoncimit asnjë material shtesë që të ketë të bëjë me procese hetimore të zhvilluara nga ky subjekt rivlerësimi.

44.2 Për sa më sipër, lidhur me trajtimin e këtij denoncimi, Komisioni vlerëson se denoncuesi nuk ka paraqitur të dhëna dhe dokumentacion mbi bazën e të cilave do mund të vlerësohej veprimtaria etiko-profesionale e subjektit të rivlerësimit, z. Anton Martini.

45. Denoncimi nr. *** prot., datë 13.4.2018, i shtetasve D. D., A. D., dhe D. D.

45.1 Denoncohet subjekti i rivlerësimi se në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjirokastrë Shkodër ka kryer shkelje flagrante të ligjit, konkretisht, duke mos zbatuar procedurat e duhura ligjore ndaj kallëzimit të bërë nga denoncuesit. Gjithashtu, denoncuesit pretendojnë se nuk janë informuar për veprimet hetimore të ndërmarra, si dhe për afatet e tejkaluara hetimore.

45.2 Nga verifikimi i kësaj ankese vërehet se denoncuesit nuk pasqyrojnë kërkesat konkrete të paraqitura në organin procedues, për të cilat nuk është kthyer përgjigje. Gjithashtu, nuk kemi të dhëna nëse denoncuesit kanë ushtruar ankim në gjykatë, për moskthimin e përgjigjeve nga organi procedues (referuar dispozitave të Kodit të Procedurës Penale).

45.3 Kjo ankesë i është drejtuar edhe Prokurorit të Përgjithshëm, znj. Arta Marku, dhe rezulton se është trajtuar në raportin për vlerësimin e aftësisë profesionale⁶¹ të hartuar nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, për këtë subjekt. Prokuroria e Përgjithshme, në shqyrtimin e saj, nuk ka gjetur elementë apo *indicie* për nisjen e procedimit disiplinor ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Anton Martini.

45.4 Komisioni, me qëllim verifikimin e plotë të rrethanave që lidhen me këtë denoncim, i kërkoi Prokurorisë së Rrethit Gjirokastrë Shkodër⁶² kopje të memorieve apo kërkesave me shkrim të bëra nga palët apo përfaqësuesit e tyre (veçanërisht nga kallëzuesit) lidhur me këtë procedimin objekt ankimi.

⁶⁰ Raporti nr. ***prot., datë 7.6.2018.

⁶¹ Raporti nr. ***prot., datë 7.6.2018.

⁶² Shkresa nr. *** prot., datë 17.9.2019.

45.5 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër⁶³ dërgoi në Komision dosjen e plotë të këtij procedimi penal. Nga verifikimi i kësaj dosjeje konstatohet se kemi të bëjmë me një çështje penale komplekse. Sikurse evidentohet edhe nga ankesa e depozituar në Prokurorinë e Përgjithshme, ankesat e kallzuesve fillimisht kanë qenë në drejtim të oficerit të policisë gjyqësore që ka ndjekur çështjen dhe, më tej, edhe ndaj z. Anton Martini, në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë.

45.6 Rezulton se oficeri i dosjes ka informuar disa herë drejtuesit e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe prokurorët e çështjes lidhur me ecurinë e kësaj dosjeje dhe madje, në një rast, ka kërkuar që prej tyre të vlerësohet mundësia e zëvendësimit të tij, nisur nga presionet e ushtruara nga të dyja palët e interesuara për çështjen, si dhe paragjykimin e krijuar ndaj tij.

45.7 Në periudhën gjatë së cilës është hetuar kjo dosje, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka ndërruar tri herë drejtuesin. Duket se në periudhën gjatë së cilës ka qenë drejtues z. Anton Martini janë kryer edhe veprimet hetimore më dinamike dhe konkrete lidhur me këtë dosje, që kanë kulmuar me nxjerrjen e masës së sigurisë “arrest me burg”, për noteren e kallzuar nga ankuesit. Kjo shkresë duket si një nga të paktat të firmosura direkt nga z. Anton Martini për këtë çështje, në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë. Shkresat e tjera hetimore kryesisht janë firmosur me urdhër dhe delegim nga zv/drejtuesi i prokurorisë.

45.8 Rezulton se në dosje gjenden memorie dhe kërkesa nga palët e interesuara. Në dy raste kërkesat e depozituara nga ankuesit (njëra nga institucioni i avokatit të popullit pas kërkesës së ankuesve) duket se janë trajtuar nga z. Anton Martini, në cilësinë e drejtuesit. Në të dyja këto kërkesa z. Anton Martini, në cilësinë e drejtuesit, ka bërë siglimet përkatëse, duke ia kaluar prokurorit të çështjes për t’i trajtuar dhe kthyer përgjigje. Në dosje ndodhen edhe shkresa kthim-përgjigje të prokurores së çështjes drejtuar ankuesve, bazuar në kërkesat e bëra prej tyre.

45.9 Subjekti i rivlerësimit, pasi iu kërkuar të jepte shpjegimet lidhur me këtë denoncim, në prapësimet e dërguara në Komision, ndër të tjera, ka shpjeguar se nuk ka kryer asnjë veprim hetimor në këtë procedim penal, por se në cilësinë e drejtuesit ka mbështetur hetimin që po kryente prokurorja Sh.M., dhe oficeri i policisë gjyqësore, z. M. Në vijim, subjekti ka sqaruar se në të gjitha rastet që ka sigluar shkresa (ku përfshihen kërkesat e ankuesve) në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër në lidhje me këtë hetim, ka lënë shënimet e tij për kthim përgjigje dhe informimin e kallzuesve, si dhe institucioneve të tjera si, prokuroria dhe Avokati i Popullit.

45.10 Subjekti i rivlerësimit arriti të provojë se në dosjen e këtij procedimi penal të administruar nga Komisioni dhe të vëna në dispozicion të tij me rezultatet e hetimit, kishte kërkesa për informacion nga Avokati Popullit, Prokuroria e Përgjithshme dhe dy-tri raste nga kallzuesit – por se aty nuk gjendeshin përgjigjet e prokurorisë. Subjekti depozitoi si prova të reja: (i) shkresën nr. *** prot., datë 12.2.2018, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me lëndë “kthim përgjigje”, drejtuar z. A.D.; (ii) shkresën nr. *** prot., datë 3.4.2018, me lëndë “kthim përgjigje”, drejtuar z. D.D.; (iii) shkresën nr. *** prot., datë 4.6.2018, me lëndë “kthim përgjigje”, drejtuar z. D.D.; (iv) shkresën nr. *** prot., datë 28.5.2018, me lëndë “kthim përgjigje”, drejtuar shtetasve D.D., D.D., A.D., D.D., dhe, për dijeni, Prokurorisë së Përgjithshme; dhe (v) shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2018, me lëndë “kthim përgjigje”, drejtuar Avokatit të Popullit.

⁶³ Shkresa nr. *** prot., datë 30.9.2019.

45.11 Për sa më sipër, nga analiza e akteve të këtij procedimi penal, shpjegimeve dhe provave të reja të depozituara nga subjekti, Komisioni vlerëson se nuk ka të dhëna për të provuar pretendimet e denoncuesve për gjetje, që do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale dhe në figurën e subjektit të rivlerësimit.

46. Denoncimi nr. *** prot., datë 6.8.2018, i shtetasit M.G.

46.1 Denoncuesi pretendon se djali i tij është dënua padrejtësisht për një vepër penale që nuk e ka kryer dhe se vendimi është marrë pa u bazuar në prova konkrete.

46.2 Nga verifikimi i këtij denoncimi duket se prokurori Anton Martini përmendet si prokurori që ka pasur fillimisht çështjen në hetim dhe sipas denoncuesit ka kërkuar pezullimin e hetimeve ndaj djalit të tij. Më tej, çështjen e ka ndjekur një prokuror tjetër. Pra, duket se ky denoncim nuk është bërë ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Anton Martini.

47. Denoncimi nr. *** prot., datë 5.6.2019, i shtetasit N.S.

47.1 Denoncuesi pretendon se është dënua padrejtësisht për një vepër penale që nuk e ka kryer dhe se vendimi është marrë pa u bazuar në asnjë fakt dhe provë.

47.2 Çështja për të cilën ngrihen pretendime nga denoncuesi ka të bëjë me një ngjarje të ndodhur në Rrëshen në vitin 2000, ku tentativa për vjedhjen e sediljeve të një automjeti është pasuar nga një ngjarje kriminale, në të cilën ka mbetur i vrarë punonjësi policisë Gj.P., janë plagosur tre punonjës të tjerë policie, si dhe roja e objektit. Për këtë ngjarje, denoncuesi është deklaruar fajtor dhe është dënua përfundimisht me burgim të përjetshëm.

47.3 Denoncuesi pretendon se të pandehurit e tjerë të kësaj çështjeje i kanë dhënë mitë prokurorit Anton Martini dhe se, si rrjedhim, ka ideuar me shpifje dhe intriga akuzat ndaj tij dhe të vëllezërve të tij, duke shmangur nga përgjegjësia autorët e vërtetë të ngjarjes. Nisur nga këto rrethana, denoncuesi pretendon se të pandehurit e kësaj çështjeje janë trajtuar me standarde të ndryshme. Gjithashtu, ai pretendon se në hetimin e kësaj çështjeje subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit, ka kryer falsifikime të shumta.

Verifikimet e para të kryera lidhur me këtë denoncim

47.4 Lidhur me këtë ankesë, Komisioni fillimisht kreu verifikime në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë, nga ku u shkarkua vendimi nr. ***, datë 12.1.2011, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë⁶⁴. Ndërsa, të dhënat e tjera lidhur me ecurinë e çështjes janë marrë nga raporti për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Anton Martini (f. 48, 49 dhe 50).

47.5 Ka rezultuar se çështja penale në ngarkim të ankuesit N.S., dhe të të gjykuarve B.S., T. S., A.R., T.Gj., dhe D.S., është dërguar për gjykim nga Prokuroria e Shkallës së Parë për Krime të Rënda në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, për ngjarjen e datës 28.6.2000, të ndodhur në periferi të qytetit të Rrëshenit, tek ***, vend i përshtatur për parkim makinash, në të cilën, gjatë tentativës për të vjedhur pjesë të një automjeti të parkuar, autorët kanë hapur zjarr ndaj forcave të policisë dhe, për rrjedhojë, ka mbetur i vrarë polici Gj.P., dhe janë plagosur kolegët e tij, shtetasit N.M., N.C., B.J., si dhe shtetasi P.Gj., roja i parkimit.

47.6 Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 28.4.2010, ka deklaruar fajtor për të gjitha akuzat e ngritura ndaj tyre shtetasit N.S., dhe D.N., (***) duke i dënua përfundimisht me burgim të përjetshëm, ndërsa të pandehurit e tjerë i ka

⁶⁴ http://www.gjykata.e.larte.gov.al/web/kerkim_per_vendime_37_1.php

deklaruar fajtorë, duke i dënuar për konsumimin e veprës penale “vjedhje me armë”, e kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 140-25-22, i Kodit Penal.

47.7 Vendimi i mësipërm është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 10.9.2010, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, e cila ka vendosur mospranimin e ankimit të ngritur nga mbrojtësi ligjor i të pandehurit D.N., (***)).

47.8 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. ***, datë 12.1.2011, ka vendosur prishjen e vendimit të dy gjykatave dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me një tjetër trup gjykues.

47.9 Vërehet se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se të dyja vendimet e gjykatave të faktit janë rrjedhojë e shkeljes së normave procedurale (edhe nga ato që e bëjnë të pavlefshëm vendimin gjyqësor), si dhe i zbatimit të keq dhe interpretimit të gabuar të ligjit. Konkretisht, ka konstatuar se Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë nuk ka respektuar kërkesat e nenit 141, të Kodit të Procedurës Penale për njoftimin e të pandehurit kur nuk gjendet, si dhe në kundërshtim me kërkesat e nenit 342/4, të Kodit të Procedurës Penale, gjyqtari F.P., nuk është njohur me përmbajtjen e procesit gjyqësor dhe të shprehjeve për mënyrën e vazhdimit të gjykimit, kur ka zëvendësuar në gjykatën e shkallës së parë, për shkaqe të përiligjura, një nga anëtarët e trupit gjykues. Njohja me aktet e procesit gjyqësor dhe shprehja e mendimit për vazhdimin e gjykimit do të legjitimonte pjesëmarrjen e këtij gjyqtari në përbërjen e atij trupi gjykues, fakt i cili nuk ka ndodhur, përderisa nuk është pasqyruar në procesverbalin e seancës gjyqësore, siç parashikon neni 346/1, i Kodit të Procedurës Penale.

47.10 Mosrespektimi i dispozitave të mësipërme e ka bërë vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë të pavlefshëm, në kuptim të nenit 128/1/a dhe germa “c” të Kodit të Procedurës Penale.

47.11 Në rigjykim, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 21.11.2012, ndër të tjera, ka vendosur deklarimin fajtor për të gjitha akuzat e ngritura ndaj tyre për shtetasit N.S., dhe D.N., (***), duke i dënuar përfundimisht me burgim të përjetshëm, ndërsa të pandehurit e tjerë i ka deklaruar fajtorë dhe i ka dënuar vetëm për kryerje të veprës penale “vjedhje me armë”, të kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 140-25-22, i Kodit Penal dhe për një nga të pandehurit edhe për akuzën “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2/3 të Kodit Penal.

47.12 Kundër këtij vendimi penal ka ushtruar ankim Prokuroria e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe të pandehurit, nëpërmjet mbrojtësve të tyre ligjorë, kanë ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, e cila, me vendimin nr. ***, datë 26.3.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 21.11.2011, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

47.13 Kundër këtij vendimi penal nga palët është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila, me vendimin nr. ***, datë 25.9.2014, ka vendosur mospranimin e rekurseve të paraqitura.

47.14 Nga verifikimi i këtij denoncimi nuk rezulton të jetë dhënë ndonjë fakt apo rrethanë konkrete nga mund të provohen pretendimet e denoncuesit për përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive.

47.15 Duket se të trija shkallët e gjyqësorit nuk kanë konstatuar shkelje të natyrës procedurale të pretenduara nga denoncuesi, si të kryera nga prokurori i çështjes Anton Martini gjatë hetimit të kryer për këtë çështje.

47.16 Bazuar në pikën 4, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësimi i aftësive profesionale të prokurorëve çmohet pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën që vlerësohet.

47.17 Nisur nga sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se faktet dhe shkaqet për të cilat bëhet ankesa, të cilat lidhen me mënyrën e përfundimit të themelit të çështjes, nuk janë objekt shqyrtimi nga Komisioni në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

47.18 Konstatohet se për të njëjtën çështje shtetasi N.S., ka bërë ankesë drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm dhe se, gjithashtu, bazuar në një ankesë të mëparshme të tij Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***, të vitit 2017. Kjo ankesë dhe kallëzimi i bërë ndaj prokurorit Anton Martini janë trajtuar në mënyrë të detajuar në raportin për vlerësimin e aftësisë profesionale⁶⁵, të hartuar nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme për këtë subjekt.

47.19 Lidhur me ankesën e depozituar ndaj prokurorit Anton Martini, Prokuroria e Përgjithshme, në shqyrtimin e saj, nuk ka gjetur elementë apo *indicie* për nisjen e procedimit disiplinor.

47.20 Ndërsa, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, pasi nuk ka konstatuar elementë të veprës penale, ka vendosur mosfillimin e hetimeve në lidhje me kallëzimin penal nr. ***, të vitit 2017.

47.21 Ndër të tjera, në vendimin e mosfillimit arsyetohet: “Nga verifikimet e kryera nuk ka rezultuar asnjë *indicie* që prokurori apo gjyqtarët që kanë gjykuar çështjen penale ndaj kallëzuesit në të gjitha shkallët e gjyqësorit, të kenë konsumuar elementë të veprës penale të korrupsionit apo të ndonjë vepre tjetër të parashikuar në legjislacionin material penal. Në pretendimet e shtetasit N.S., nuk evidentohet ndonjë *indicie*, fakt apo provë që mund të përbëjë dyshim të arsyeshëm mbi ekzistencën e elementëve të ndonjë vepre penale. Në pretendimet e tij kallëzuesi nuk ka dhënë asnjë fakt apo provë konkrete që prokurori apo gjyqtarët e çështjes në ngarkim të tij të kenë marrë/kërkuar rryshfet apo forma të tjera të korrupsionit, por dyshimet e tij bazohen vetëm në perceptimet që prokurori apo gjyqtarët kanë dhënë një vendim të pabazuar në ligj, në kundërshtim me pretendimet e tij.”

47.22 Lidhur me këtë vendim të mosfillimit të hetimeve, nuk është paraqitur ankim nga kallëzuesi.

Hetimi i mëtejshëm i kryer nga Komisioni

47.23 Me qëllim verifikimin e fakteve të denoncuara, që kanë të bëjnë me trajtimin e diferencuar të të pandehurve në këtë dosje dhe dyshimet e hedhura për ndryshimin e qëndrimit të prokurorit, Komisioni fillimisht i kërkoi⁶⁶ Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda të dërgojë dokumentet, si vijon: (i) kërkesën për dërgimin e çështjes për

⁶⁵ Raporti nr. *** prot., datë 7.6.2018.

⁶⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 17.9.2019.

gjykim; dhe (ii) parashtrimet përfundimtare, të paraqitura nga prokurori i çështjes para Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

47.24 Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar⁶⁷ konfirmohet se (qëndrimi i prokurorit):

i. Referuar dokumentit “kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2007”, datë 6.6.2008, rezulton se prokurori Anton Martini ka ngritur akuzë të njëjtë (vjedhje + vrasje) për 6 të pandehurit e kësaj dosjeje, dhe se për 4 të pandehur ka ngritur edhe akuzën për prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake.

ii. Referuar dokumentit “konkluzione përfundimtare”, datë 19.3.2010, prokurori ka kërkuar deklarimin fajtor të 6 të pandehurve për të njëjtat vepra penale vrasje + vjedhje – dhe për 4 të pandehurit ka kërkuar deklarimin fajtor edhe për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake”.

iii. Referuar dokumentit “konkluzione përfundimtare”, datë 8.11.2011, rezulton se prokurori Anton Martini ka kërkuar deklarimin fajtor të z. N.S., për konsumimin e veprave penale: (1) “vrasje me dashje për shkak të cilësive të veçanta”, e kryer në bashkëpunim (në 4 raste e mbetur në tentativë); (2) “vjedhje me armë”, të mbetur në tentativë, të kryer në bashkëpunim; (3) “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake” – dhe se ka tërhequr akuzën e vrasjes/vrasjes së mbetur në tentativë, të kryer në bashkëpunim, për 4 nga të pandehurit, përfshirë këtu edhe 2 vëllezërit e denoncuesit.

47.25 Referuar dokumentacionit të administruar duket se Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 28.4.2010, ndër të tjera, ka vendosur deklarimin fajtor të shtetasve D.N., dhe N.S., për veprat penale të vrasjes, vjedhjes dhe armëmbajtjes pa leje (të specifikuar më lart) dhe deklarimin e pafajshëm të 4 të pandehurve të tjerë për konsumimin e veprës penale “vrasje/vrasje e mbetur në tentativë”.

47.26 Në lidhje me ankimin e bërë nga të pandehurit, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr. ***, datë 10.9.2010, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

47.27 Të pandehurit kanë ushtruar rekurs ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë. Në datën 12.1.2011 Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimeve të mësipërme dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

47.28 Gjatë rigjykimit të kësaj çështjeje gjykata ka vendosur ndarjen e akteve në ngarkim të të pandehurit D.N., (***) , nga aktet e të pandehurve të tjerë.

47.29 Për sa më sipër, duket se prokurori Anton Martini, në konsideratë të qëndrimit të mbajtur paraprakisht nga gjykata (vendimi nr. ***, datë 28.4.2010, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda), në konkluzionet përfundimtare gjatë rigjykimit të çështjes ka tërhequr akuzat për vrasje për 4 të pandehurit.

47.30 Referuar dokumentit “konkluzione përfundimtare”, datë 6.4.2012, rezulton se prokurori Anton Martini ka kërkuar deklarimin fajtor z. D., (***) S., për konsumimin e veprave penale: (1) “vrasje me dashje për shkak të cilësive të veçanta”, e kryer në bashkëpunim (në 4 raste e

mbetur në tentativë); (2) “vjedhje me armë”, të mbetur në tentativë, të kryer në bashkëpunim, (3) “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake”.

47.31 Nga shqyrtimi i këtij denoncimi, ndër të tjera, konstatohet se denoncuesi ka hedhur dyshime se prokurori Anton Martini është përfshirë në veprime korruptive. Sipas tij, bashkë-të pandehurit me të në këtë çështje i kanë dhënë mitë prokurorit – dhe kanë ideuar me shpifje dhe intriga akuzat ndaj tij dhe vëllezërve të tij, me qëllim shmangien nga përgjegjësia të autorëve të vërtetë të ngjarjes.

47.32 Nga verifikimi i këtij denoncimi duket se me “të pandehur të tjerë” – denoncuesi ka parasysh shtetasit T.Gj., A.R., dhe D.N., të pandehur të cilët nuk janë vëllezërit e tij.

47.33 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar konstatohet se prokurori Anton Martini ka tërhequr akuzat e vrasjes për 4 të pandehur, mes të cilëve dhe 2 vëllezërit e denoncuesit, ndërsa për të pandehurin D.N., (që supozohet të jetë pjesë e të pandehurve që i kanë dhënë mitë prokurorit dhe pjesë e skemës që ka ideuar shpifje për të dënuar denoncuesin dhe vëllezërit e tij), ka kërkuar deklarinim fajtor për të njëjtat akuza si denoncuesi, duke kërkuar dënimin e tij me burgim të përjetshëm.

47.34 Në një vlerësim tërësor të të gjithë të dhënave të mësipërme vlerësohet se pretendimet e ankuesit/denoncuesit për trajtim të diferencuar të të pandehurve të tjerë, duke hedhur dyshimin për përfshirjen e prokurorit në veprime korruptive, nuk qëndrojnë.

47.35 Në vijim të veprimeve hetimore lidhur me këtë rast, me qëllim verifikimin e të gjitha pretendimeve të ngritura nga denoncuesi, Komisioni kërkoi⁶⁸ nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë për Krime të Rënda dosjen e plotë të procedimit penal nr. ***, të vitit 2007, objekt i kësaj ankese. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dërgoi⁶⁹ në Komision fashikullin e plotë të këtij procedimi penal.

47.36 Nga verifikimi dhe studimi i kësaj dosjeje duket se nuk ka *indicie* për të provuar pretendimet e denoncuesit për gjetje thelbësore që do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale dhe në figurën e subjektit të rivlerësimit, z. Anton Martini.

47.37 Edhe lidhur me pretendimin e ngritur nga denoncuesi për falsifikim procesverbali (duke iu referuar procesverbalit të marrjes në pyetje të shtetasit L.S., (N.) në datën 16.7.2007) konstatohet se prokurori Anton Martini, me letrën e datës 2.9.2010 (nisur dhe nga fakti se është kallëzuar në prokurori pikërisht për këtë rrethanë), ka informuar Prokurorin e Përgjithshëm, duke pasqyruar në mënyrë të detajuar procesin e marrjes në pyetje të shtetasit L.S., (N.), duke depozituar edhe provat përkatëse, që kundërshtonin pretendimet e ngritura në kallëzim, por edhe në median e shkruar, nga avokati i z. N.S.

47.38 Për sa më sipër, nga shqyrtimi në tërësi i kësaj/këtij ankese/denoncimi, nuk vërehen fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit në aspektin profesional dhe të figurës, për subjektin e rivlerësimit, z. Anton Martini.

48. Denoncimi nr. *** prot., datë 27.6.2019, i shtetasit E.S.

⁶⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 18.10.2019.

⁶⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 18.10.2019.

48.1 Ky denoncim, i kryer nga z. E.S., (i paidentifikuar me gjeneralitete të plota), referon të dhëna lidhur me kredinë e butë të marrë nga prokurori Anton Martini dhe me ndryshimin e destinacionit të saj.

48.2 Lidhur me këtë denoncim dhe dyshimet e hedhura për përdorimin e kredisë së butë për qëllime fitimi, në prapësimet e dërguara në Komision subjekti i rivlerësimit dha shpjegimet e tij, të cilat konsistojnë në: (i) kredinë e butë, e cila ka pasur si qëllim përfundimtar pagesën për blerjen e pasurisë së paluajtshme (apartament banimi) të vetme të tij, pra, destinacioni final ka qenë strehimi; si dhe (ii) të ardhurat e pakta të përfituara nga vendosja e shumës së kësaj kredie në bono thesari/depozitë/fond investimi, të cilat kanë shërbyer për mbulimin një pjese të shpenzimeve të qirasë, të cilat në vetvete përbëjnë shpenzime për strehimin e tij dhe të familjes së tij.

48.3 Më gjerësisht, përfitimi, mbajtja dhe destinacioni i shumës së përfituar nga kredia lehtësuese është trajtuar me hetimin e kryer për pagesën e kësaj të parë të pasurisë apartament banimi, aktualisht në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes.

48.4 Për sa më sipër, nga vlerësimi tërësor dhe në harmoni të të gjitha rrethanave dhe fakteve lidhur me përfitimin, mbajtjen dhe destinacionin e shumës së përfituar nga kredia e butë, trupi gjykues vlerëson se të gjitha shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, në kuadër të këtij procesi administrativ, duken bindëse dhe të bazuara në dokumentacion provues.

49. Denoncimi nr. *** prot., datë 11.12.2019, depozituar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit pas zhvillimit të seancës dëgjimore datë 10.12.2019.

49.1 Përmbajtja e denoncimit: (i) denoncuese: L.M., (nuk ka dhënë gjeneralitete të plota); (ii) objekti: denoncohet subjekti i rivlerësimit për veprime të kryera kryesisht në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër; dhe (iii) përshkrimi i denoncimit: denoncohet subjekti i rivlerësimit për kryerjen e disa shkeljeve të rënda në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Denoncuesja hedh dyshime se subjekti i rivlerësimit, z. Anton Martini, ia ka hequr dosjet hetimore disa prokurorëve, duke ia kaluar prokurorëve të tjerë – pa dhënë dorëheqjen të parët dhe pa një vendim që të justifikonte kalimin e dosjeve.

Hetimi i kryer nga Komisioni

49.2 Komisioni i kërkoi⁷⁰ Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër informacion mbi të gjitha rastet e zëvendësimit të prokurorit dhe të gjitha vendimet përkatëse të drejtuesit të prokurorisë, që i përkasin periudhës gjatë së cilës drejtues i komanduar i kësaj prokurorie ka qenë subjekti i rivlerësimit, z. Anton Martini.

49.3 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër dërgoi⁷¹ vendimet e zëvendësimit të prokurorit (në total 56), që i përkasin periudhës gjatë së cilës drejtues i komanduar i kësaj prokurorie ka qenë subjekti i rivlerësimit, z. Anton Martini, të cilat janë nënshkruar prej tij.

49.4 Pas verifikimit paraprak të këtyre vendimeve u konstatua se përgjithësisht ato janë të arsyetuara, por referojnë në akte të tjera, si p.sh.: vendime për komandime prokurorësh në

⁷⁰ Shkresa nr. *** prot., datë 12.12.2019.

⁷¹ Shkresa nr. *** prot., datë 18.12.2019.

prokurori të tjera apo në Prokurorinë e Përgjithshme si pjesëtarë të Grupit të Punës për hartimin e raporteve të vlerësimit profesional, në kuadër të procesit të rivlerësimit; vendim për riorganizimin e seksioneve në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër; kërkesa të bëra nga të pandehurit për zëvendësimin e prokurorit; kërkesa të vetë prokurorëve për zëvendësim; leje vjetore të marrë nga prokurorët e çështjes; apo referojnë dosje të ardhura nga prokurori të tjera, etj.

49.5 Në vijim të kryerjes së veprimeve hetimore, me qëllim kryerjen e një hetimi sa më të plotë dhe të gjithanshëm, Komisioni kërkoi⁷² nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër dokumentacionin mbi bazën e të cilit janë arsyetuar vendimet për zëvendësimin e prokurorit, rast pas rasti, si dhe nëse ka pasur raste në të cilat prokurori i zëvendësuar të ketë paraqitur ankesë kundër vendimit të zëvendësimit.

49.6 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër dërgoi⁷³ dokumentacionin mbi bazën e të cilit janë arsyetuar vendimet e zëvendësimit të prokurorit si dhe informoi se nuk rezultoi të ketë pasur ndonjë rast ankimi ndaj vendimit të zëvendësimit të drejtuesit të prokurorisë.

49.7 Analiza ligjore e këtij denoncimi është ligji i aplikueshëm: (i) neni 53, i ligjit nr. 84/2016; (ii) ligji nr. 7905, datë 21.3.1995, (iii) Kodi i Procedurës Penale, i ndryshuar; (iv) ligji nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”; si dhe (v) udhëzimi nr. 3, datë 29.12.2016, i Prokurorit të Përgjithshëm, “Për rishpërndarjen e çështjeve në prokurori”.

49.8 Nga verifikimi i vendimeve të zëvendësimit të prokurorit (në total 56 vendime), për periudhën që drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka qenë subjekti i rivlerësimit, z. Anton Martini, konstatohet se:

i. Në 32 raste zëvendësimi i prokurorit është bërë për shkak të komandimit të prokurores E.N., në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, si rrjedhojë, drejtuesi i prokurorisë Anton Martini, me anë të zëvendësimit, ka rishpërndarë në prokurorë të tjerë dosjet që prokurorja kishte dërguar në gjykim apo ato që kishte në hetim. Këto vendime janë të datave 13.12.2017, 14.12.2017, 29.12.2017 dhe 8.1.2018. Konfirmohet se me vendimin nr. ***, datë 7.12.2017, të Prokurorit të Përgjithshëm, znj. E.N., prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, caktohet përkohësisht në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ii. Në 13 raste zëvendësimi i prokurorit është bërë për shkak të caktimit me kohë të plotë të prokurorëve A.S., dhe M.F., në pozicionin e përkohshëm në mbështetje të Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, që harton raportet e vlerësimit të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit. Këto vendime janë të datave 18.1.2018, 29.1.2018, 29.1.2018, 20.2.2018 dhe 2.3.2018. Konfirmohet se me vendimin nr. ***, datë 9.1.2018, “Për riorganizimin e Grupit të Punës për hartimin e raportit në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit kalimtar”, prokurorët M.F., dhe A.S., janë caktuar me kohë të plotë në mbështetje të Grupit të Punës për hartimin e projekt-raportit, në kuadër të procesit të “Vetting”-ut.

iii. Në 4 raste zëvendësimi i prokurorit është bërë me arsyetimin se për procedimet në fjalë ka rezultuar e nevojshme kryerja e veprimeve të tjera hetimore, si dhe bazuar në urdhrin nr. ***,

⁷² Shkresa nr. *** prot., datë 18.12.2019.

⁷³ Shkresa nr. *** prot., datë 23.12.2019.

datë 16.1.2018, të drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, “Për organizimin e seksioneve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër”. Këto vendime janë të datës 18.1.2018 dhe në datën 16.1.2018 rezulton se z. Anton Martini, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka nxjerrë urdhrin nr. ***, “Për riorganizimin e seksioneve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër”. Duket se në këtë rast z. Anton Martini, në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, ka bërë zëvendësimin e prokurorëve nisur nga sfera e veprave penale për të cilat janë regjistruar këto procedime, si dhe seksioni përkatës ku ato përfshihen.

iv. Në 2 raste zëvendësimi i prokurorit/caktimi i prokurorit është bërë për shkak se Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka shpallur moskompetencën e saj dhe i ka dërguar aktet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në këto rrethana, drejtuesi i prokurorisë Anton Martini, në lidhje me hetimin dhe përfaqësimin në gjykim të këtyre çështjeve, ka caktuar prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

v. Në 1 rast zëvendësimi i prokurorit është bërë për shkak të marrjes së lejes vjetore, dhe konkretisht, vendimi i datës 29.5.2018, për zëvendësimin e prokurores M.Sh. Konfirmohet se, me vendimin nr. ***, datë 9.11.2017, të Prokurorit të Përgjithshëm, znj. M.Sh., prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, i është akorduar leje prindërore për shkëputjen nga puna, nga data 20.11.2017 deri më 31.12.2018.

vi. Në 4 raste është bërë zëvendësimi i prokurorit për shkak të kërkesave për zëvendësim të bërë nga vetë prokurorët apo të pandehurit.

a. Në një rast konstatohet se ka kërkesa të përsëritura nga të pandehurit për largimin dhe zëvendësimin e prokurorit, por edhe kërkesë për dorëheqje nga vetë prokurori i çështjes (z. F.L.) nga përfaqësimi i akuzës në gjyq, që ka të bëjë me të njëjtën çështje (kërkesë e bazuar në nenin 17, të Kodit të Procedurës Penale). Në këto kushte dukej se nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, kishte vendosur zëvendësimi i këtij prokurori.

b. Në një rast konstatohet se prokurorja e çështjes Sh.M., ka paraqitur kërkesën për zëvendësimin e saj, me argumentimin se ka shprehur verbalisht mendimin e saj lidhur me rastet identike (rastet e ngjashme), por gjithashtu sepse edhe më parë ka kërkuar zëvendësimin e saj në hetimin e këtyre rasteve, për shkak të shprehjes publikisht të qëndrimit të saj. Në këto kushte, dukej se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, kishte vendosur zëvendësimin e kësaj prokuroreje.

c. Në një rast konstatohet se prokurori E.L., për shkak të ngarkesës së madhe me dosje në hetim dhe gjykim, ka kërkuar zëvendësimin e tij në një procedim, për të cilin drejtuesi i prokurorisë kishte caktuar grup hetimor të përbërë nga dy prokurorë (kërkesa datë 28.2.2018). Në këto kushte, dukej se në datën 2.3.2018 subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, kishte vendosur zëvendësimin i këtij prokurori, në konsideratë edhe të faktit se prokurorja E.N., e cila ishte vendosur të zëvendësojë prokurorin E.L., është kthyer në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

d. Në një rast është bërë zëvendësimi për shkak të kërkesës së bërë nga prokurori A.M., i cili ka parashtruar se për shkak të detyrës si zv/drejtues i prokurorisë dhe ngarkesës me dosje hetimore, si dhe për shkak të natyrës së veprave penale për të cilat është regjistruar procedimi në fjalë, është në pamundësi objektive për vazhdimin e hetimeve të këtij procedimi penal.

49.9 Nga vlerësimi në tërësi i rasteve të zëvendësimit të prokurorit rezulton se ekzistojnë shkaqet ligjore të zëvendësimit, mbi bazën e të cilave, në kuadër të kompetencave që i jep ligji, z. Anton Martini, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka vendosur zëvendësimin e prokurorëve në hetimin apo përfaqësimin në gjykim të çështjeve përkatëse dhe se nuk rezulton të ketë pasur ndonjë rast ankimi ndaj vendimit të zëvendësimit.

49.10 Gjithsesi, me dërgimin e rezultateve shtesë të hetimit⁷⁴, të cilat bazoheshin vetëm në shqyrtimin e këtij denoncimi, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit mbi hapat e ndërmarra prej tij për riorganizimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, si dhe mbi respektimin e kritereve ligjore në procedurën e rishpërndarjes së çështjeve.

49.11 Në prapësimet e dërguara pas rezultateve shtesë të hetimit, si dhe shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore datë 27.1.2020, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, sqaroi se:

i. Së pari, në nëntor të vitit 2017 është komanduar si drejtues i përkohshëm i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, detyrë të cilën e ka mbajtur deri në qershor të vitit 2018. Z. Anton Martini ka shpjeguar se nuk ka qenë ai që ka kërkuar të jetë drejtues i kësaj prokurorie (madje e ka kundërshtuar vendimin), por ka qenë një vendim i njëanshëm i ish-Prokurorit të Përgjithshëm.

ii. Së dyti, në përfundim të vitit 2017, pasi u bë analiza vjetore nga ana e tij, në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, bazuar në kompetencat që i njihte ligji, u vlerësua që, me qëllim përmirësimin e punës për vitin në vijim të bëhej riorganizimi i seksioneve brenda prokurorisë.

iii. Së treti, lidhur me mënyrën e ndarjes së procedimeve penale gjatë periudhës që ka qenë drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, dosjet dhe materialet e tjera kallëzuese apo referuese janë hedhur në short elektronik dhe se, në raste të rralla që ka pasur problem teknik sistemi (i cili monitorohet nga zyra e Prokurorit të Përgjithshëm), materialet janë hedhur në short manual midis prokurorëve të seksionit, sipas grup-veprave penale. Gjithashtu, shpjegon se, në rastet e largimit të prokurorëve, komandimit të tyre në prokurori të tjera, ndryshimit të seksioneve apo heqjes dorë të prokurorit nga çështje të caktuara, dosjet janë hedhur në short manual, pasi sistemi elektronik nuk parashikon rihedhje në short.

iv. Së katërti, argumenton se është mundur të ketë një ndarje të barabartë, aq sa është e mundur, si midis prokurorëve brenda seksioneve, apo prokurorëve në përgjithësi, bazuar në ngarkesën që ka pasur secili sektor në periudha të ndryshme.

49.12 Lidhur me ndarjet e dosjeve pas largimit të prokurorëve E.N.,⁷⁵ M.F., dhe A.S.,⁷⁶ z. Anton Martini shpjegon se ato janë depozituar prej tyre në sekretarinë e prokurorisë dhe janë hedhur në short manual në seksionet sipas veprave penale që ishin regjistruar.

49.13 Për të provuar deklaratimet e tij subjekti ka depozituar si provë të re në Komision shkresën nr. *** prot., datë 17.1.2020, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

49.14 Referuar kësaj shkrese konstatohet se, konfirmohen shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, për sa i përket procedurës mbi mënyrën e shpërndarjes së procedimeve penale, dosjeve kallëzuese apo referuese (nëpërmjet shortit elektronik), si dhe zhvillimin e shortit

⁷⁴ Dërguar subjektit të rivlerësimit në datën 15.1.2020.

⁷⁵ Komanduar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me urdhrin nr. ***, datë 7.12.2017, të Prokurorit të Përgjithshëm.

⁷⁶ Komanduar në Prokurorinë e Përgjithshme, me urdhrin nr. ***, datë 9.1.2018, të Prokurorit të Përgjithshëm.

manual për rastet e largimit, komandimit të prokurorëve, ndryshimit të seksioneve apo heqjes dorë të prokurorit nga çështje të caktuara.

49.15 Për sa i përket dosjeve të dorëzuara nga prokurorët E.N., M.F., dhe A.S., mbi bazën e të cilave nga z. Anton Martini janë përpiluar pjesa më e madhe e vendimeve të zëvendësimit të prokurorit, vërehet se shkresa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, e depozituar si provë e re nga subjekti i rivlerësimit, referon një numër më të lartë dosjesh të dorëzuara nga këta prokurorë sesa informacioni i dërguar më parë në Komision nga kjo prokurori, të cilat janë ndarë ndërmjet prokurorëve, sipas seksioneve të kësaj prokurorie.

49.16 Nga verifikimi i këtij informacioni të përpunuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër duket se dosjet e dorëzuara nga këta prokurorë përgjithësisht janë ndarë në mënyrë proporcionale në prokurorë të tjerë, sipas seksioneve të organizuara në këtë prokurori.

49.17 Gjithashtu, me dërgimin e rezultateve shtesë të hetimit, por edhe gjatë seancës dëgjimore nga vëzhguesi ndërkombëtar, subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime lidhur me trajtimin e kërkesave të shtetasve D.N., dhe M.S., (të pandehur) për zëvendësimin e prokurorit F.L., për një çështje penale, e cila ishte në fazën e gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

47.18 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, shpjegoi se, paraprakisht nga vlerësimi i rrethanave nuk ka pranuar kërkesën për zëvendësim të bërë nga të pandehurit. Në vijim, pas kërkesës së përsëritur prej tyre, por edhe nga prokurori i çështjes (për heqje dorë), ka trajtuar me objektivitet këto kërkesa dhe, në vlerësim të konfliktit të lindur dhe mungesës së theksuar të besimit, ka vendosur zëvendësimin e prokurorit F.L., me një prokuror tjetër me përvojë, në konsideratë të faktit se bëhej fjalë për çështje të dërguar për gjykim dhe zëvendësimi bëhej për të përfaqësuar akuzën në gjyq, vendimmarrje e cila ka shoqëruar përfaqësimin e akuzës në gjyq, ku ankuesit kanë qenë të pranishëm dhe, si rrjedhim, kanë marrë dënimin.

49.19 Për sa më sipër, nga shqyrtimi në tërësi i këtij denoncimi, konstatohet se: (i) në çdo rast kanë ekzistuar shkaqet ligjore mbi bazën e të cilave, në kuadër të kompetencave që i jep ligji, z. Anton Martini, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka vendosur zëvendësimin e prokurorëve në hetimin apo përfaqësimin në gjykim të çështjeve përkatëse; (ii) nuk rezulton të ketë pasur ndonjë rast ankimi ndaj vendimit të zëvendësimit; si dhe (iii) referuar informacionit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për rastet e zëvendësimit, ndarja e dosjeve është bërë me short manual dhe në mënyrë proporcionale.

49.20 Për më tepër, në kushtet kur denoncuesi nuk paraqet rrethana apo fakte konkrete mbi bazën e të cilave të provohet dyshimi për qëllimin e fshehur në përpilimin e këtyre vendimeve të zëvendësimit të prokurorit dhe në kushtet kur as Komisioni nuk evidentoi situata të dyshimta në shpërndarjen e dosjeve dhe përpilimin e vendimeve të zëvendësimit, trupi gjykues vlerëson se trajtimi i këtij denoncimi merr një peshë specifike më të vogël, pasi ka të bëjë me vlerësimin e cilësive drejtuese të subjektit të rivlerësimit dhe jo me aftësitë etiko-profesionale të tij apo integritetin dhe figurën si prokuror, duke marrë në konsideratë faktin se subjekti ka qenë vetëm për rreth 7 muaj drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në rreth 21 vite karrierë si prokuror - periudhë rivlerësimi.

Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional

50. Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si më sipër, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale, apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

50.1 Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional.

50.2 Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

V. KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se:

- a. subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. subjekti ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, në nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Anton Martini, me funksion prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Ky vendim i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 29.01.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta TAFA (BUNGO)
Kryesuese

Etleda ÇIFTJA
Anëtare në pakicë/kundër

Pamela QIRKO
Relatore

Sekretare gjyqësore
Gledis Hajdini